

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

PKR. nr. 357/14

18 Shkurt 2016

[Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm]

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it, Mariola Pasnik, si kryetare e trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Katrien Witteman dhe gjyqtarja e Kosovës Naime Jashanica si anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Dea Dedi, në lëndën penale kundër:

Emri	K
Mbiemri	D.
Emri i babait	Xh.
Data e lindjes	xxx
Vendi i lindjes	xxx
Gjinia	xxx
Adresa	xxx
Kombësia	Shqiptar i Kosovës
Shtetësia	Republika e Kosovës
Letërnjoftimi	xxx

I akuzuar me Aktakuzën e Prokurores Speciale PP No.: 776-3/2012, të datës 25 qershor 2014, dhe të parashtruar në Shkrimore të Gjykatës Themelore të Prishtinës më 26 qershor 2014, për veprat penale të:

PIKA 1: RREZIKIMI I PERSONAVE NË MBROJTJE NDËRKOMBËTARE, në kundërshtim më Nenin 141 (3) të ish Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), vepër e ndëshkueshme me burgim në kohëzgjatje prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, për shkak se i pandehuri **K.D.**, në kryerje dhe bashkëkryerje më njerëz të panjohur, është përfshirë në një sulm të dhunshëm mbi mjetet e transportit të personave nën mbrojtje ndërkombëtare.

PIKA 2: DËMTIM I PASURISË SE LUAJTSHME, në kundërshtim me Nenin 260 (2) të ish Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), vepër penale e ndëshkueshme më gjobë apo burgim në kohëzgjatje deri në një vit, për shkak se i pandehuri **K.D.**, në kryerje dhe bashkëkryerje me njerëz të panjohur, ka dëmtuar pasurinë e luajtshme të personave tjerë, të motivuar nga paragjykimet që ndërlidhen me përkatësinë e tyre etnike.

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore të Prishtinës, më 14, 15 dhe 16 korrik, 1, 2 dhe 14 shtator, 7 tetor dhe 9 nëntor 2015 dhe 28 janar dhe 15 e 18 shkurt 2016, në praninë e Prokurores së PSRK-së Tiffany Corrine-Moise apo zëvendësit të saj të përkohshëm Tuomas Oja, i pandehuri **K.D.** dhe mbrojtësit e tij, avokatët M.D. apo A.S., dhe ku palët e lënduara ose ishin të pranishme ose të ftuara gjatë gjithë procesit;

Trupi gjykues, pas këshillimit dhe votimit në pajtim me Nenin 357, paragrafin 2 dhe Nenin 359 të KPP, në seancë publike dhe në prani të palëve, nxorën dhe shpallën këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri **K.D.**, më shënimet personale si mësipërm, **LIROHET** nga:

PIKA 1: RREZIKIMI I PERSONAVE NË MBROJTJE NDËRKOMBËTARE, në kundërshtim më Nenin 141 (3) të KPK-së, vepër e ndëshkueshme me burgim në kohëzgjatje prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, për shkak se i pandehuri **K.D.**, në kryerje dhe bashkëkryerje më njerëz të panjohur, është përfshirë në një sulm të dhunshëm mbi mjetet e transportit të personave nën mbrojtje ndërkombëtare.

Më 4 Prill 2012, për afërsisht rreth orës 16:15, në Prishtinë, **K.D.** ishte në mesin e një grupi të individëve të cilët hodhën gurë drejt një konvojit prej dy automjeteve që po transportonin pjesëtarët e një delegacioni Serb në një vizitë zyrtare në Kosovë. Sulmi ishte i dhunshëm për nga natyra për shkak se gurët e hedhur ishin të mëdhenj dhe rezultuan me shkatërrimin e xhamave në dy dritare të secilit automjet. Pasagjerët nuk kanë pësuar lëndime, me përjashtim të një gërvishtjeje në dorë dhe kokë të një pjesëtari të delegacionit. Megjithatë, disa pjesëtarëve të delegacionit iu

është dashur të lëvizin shpejt për në automjetet e tyre përkatëse në mënyrë që ti shmangen goditjes nga gurët. Ata ishin në gjendje ta përshkruanin sesi xhami i thyer po binte mbi ta. Me veprimet e veta, **K.D.** u përfshi në një sulm të dhunshëm mbi mjetet e transportit të personave nën mbrojtje ndërkombëtare, i cili sulm kishte të ngjarë ta rrezikonte personin apo lirinë e personave nën mbrojtje ndërkombëtare, në kundërshtim me Nenin 141 (3) të KPK-së, me personat e tillë që janë të përcaktuar edhe sipas Nenit 141 (7.2) të ish KPK-së.

PIKA 2: DËMTIM I PASURISË SE LUAJTSHME, në kundërshtim me Nenin 260 (2) të KPK-së, vepër penale e ndëshkueshme më gjohë apo burgim në kohëzgjatje deri në një vit, për shkak se i pandehuri **K.D.**, në kryerje dhe bashkëkryerje me njerëz të panjohur, ka dëmtuar pasurinë e luajtshme të personave tjerë, të motivuar nga paragjykimet që ndërlidhen me përkatësinë e tyre etnike.

Më 4 Prill 2012, përafërsisht rreth orës 16:15, në Prishtinë, **K.D.** ishte në mesin e një grupi të individëve të cilët hodhën gurë drejt një konvojit prej dy automjeteve që po transportonin pjesëtarët e një delegacioni Serb në një vizitë zyrtare në Kosovë. Sulmi ishte i dhunshëm për nga natyra për shkak se gurët e hedhur ishin të mëdhenj dhe rezultuan me shkatërrimin e xhamave në dy dritare të secilit automjet. Sulmi ishte i drejtuar në dy automjete që bartnin tabela të regjistrimit të qeverisë së Serbisë. Sulmi mbi konvojin, i cili rezultoi me dëmtime për të dy automjetet, ishte i motivuar nga paragjykimet që ndërlidheshin me përkatësinë etnike dhe kombëtare të delegacionit Serb që po udhëtonte në konvoj.

Për shkak se sipas Nenit 364.1.3 të KPP-së, nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri K.D. i ka kryer veprave penale me të cilat ai është akuzuar.

ARSYETIMI

A. RRJEDHA PROCEDURALE

1. Aktakuza në këtë rast është parashtruar më 26 qershor 2014. Përpjekjet e kryetarit të atëhershëm të trupit gjykues për ta caktuar seancën e parë dëgjimore janë penguar nga refuzimi i të pandehurit për ta pranuar thirrjen dhe ta njoh gjykatën. Kur janë bërë përpjekje për t'ia dorëzuar atij thirrjen, i pandehuri ka refuzuar ta pranoj atë dhe ka deklaruar se nuk e njeh EULEX-in.

2. Më 23 shtator 2014, Policia e Kosovës e solli të pandehurin përpara kryetarit të trupit gjykues të atëhershëm. Kryetari i atëhershëm i trupit gjykues e përcaktoi datën 20 tetor 2014, si afat të fundit përtej të cilit ai nuk do të pranonte kundërshtime ndaj provave apo kërkesa për ta hedhur aktakuzën poshtë. Më 20 tetor 2014, avokati M.D., avokat mbrojtës për të pandehurin **K.D.**, parashtroi një kërkesë për ta hedhur poshtë aktakuzën e datës 20 tetor 2014, e cila gjithashtu u dorëzua më 20 tetor 2014. Më 20 tetor 2014, i pandehuri **K.D.** gjithashtu parashtroi një kërkesë për ta hedhur poshtë aktakuzën. Me aktvendimet e datës 20 nëntor 2014, kryetari i atëhershëm i trupit gjykues i hodhi poshtë të dyja kërkesat, të avokatit mbrojtës dhe atë të pandehurit. As i pandehuri dhe as avokati i tij mbrojtës nuk kanë parashtruar ankesa kundër këtyre aktvendimeve.

3. Shqyrtimi gjyqësor filloi më 14 korrik 2015, në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Seancat vijuese u mbajtën më 15 dhe 16 korrik, 1, 2 dhe 14 shtator, 7 tetor dhe 9 nëntor 2015. Gjithashtu u mbajtën seanca më 28 janar dhe më 15 e 18 shkurt 2016.

4. Në thelb, rasti i prokurorisë ishte se më 4 prill 2012, përafërsisht në ora 16:15, i pandehuri **K.D.**, së bashku me persona tjerë të panjohur, mori pjesë në një sulm mbi një delegacion zyrtar Serb, që përbëhej prej dy automjeteve dhe shtatë zyrtarë, pas vizitës së tyre në Zyrën Kadastrale të Kosovës në Prishtinë. Prokuroria pohoi se sulmuesit hodhën gurë të cilët thyen dritaret e të dyja automjeteve, që rezultuan me lëndime të lehta për njërin nga pasagjerët. Është pohuar se i pandehuri u mundua të ikte, por është kapur në një kafiteri të afërme nga Policia e Kosovës. Është pohuar se i pandehuri ka qenë i motivuar nga paragjykimet ndaj personave të etnisë Serbe. I pandehuri u deklarua i pafajshëm ndaj të dyja akuzave.

B. PROVAT E PRANUESHME

Procedura paraprake:

5. Gjatë hetimit të këtyre veprave penale të pretenduara është siguruar një sasi e konsiderueshme e deklaratave dhe raporteve, dhe as i pandehuri e as avokati i tij mbrojtës nuk e kundërshtuan pranueshmërinë e ndonjëres nga to. Më të rëndësishmet mund të përmbliidhen siç vijon.

Raporti i zyrtarit policor të Policisë së Kosovës, Sh.K., i datës 4 prill 2012¹, thotë:

“Më 04.04.2012, në ora 13:15, pikën kufitare në Merdarë ne e morën një delegacion nga Republika e Serbisë. Delegacioni arriti në Merdarë në ora 13:15, me dy automjete. 1. Shkoda super B BG-244-KS dhe Audi A8 BG505 PA. Këto automjete po bartnin 7 (shtatë) persona [njerëz] të cilët ne i përcollëm për në Prishtinë, në Agjencinë Kadastrale të Kosovës në ndërtesën e Arkivit të Kosovës, e cila gjendet në rrugën “Muharrem Fejza”. Takimi përfundoi në ora 16:00. Në ora 16:08, ne i morëm në përcjellje të njëjtat automjete me të njëjtit pjesëtarë të

¹ Dosja e Provave të Prokurorisë në Tab 3 (versioni në gjuhën Angleze).

delegacionit, dhe u nisëm drejt Merdarit. Me të arritur në rrugën përpara hyrjes së Spitalit (QKUK), në vendkalim të këmbësorëve, automjetet e delegacionit u sulmuan me gurë nga të dyja anët, nga 5 – 7 njerëz të cilët ne nuk i pamë që ishin të mbledhur, por ata ishin këmbësorë të rastësishëm. Kur u sulmuan automjetet, ne e rritëm shpejtësinë në mënyrë që ti evakuojmë ata...”

6. Polici K. vazhdoi ta përshkruante sesi delegacioni është përcjellë drejt vendit të sigurt në një stacion të përafërt policor ku është vlerësuar dhe regjistruar dëmi i shkaktuar në automjete dhe është ofruar trajtimi mjekësor por ai është refuzuar. Në fund delegacioni është përcjellë prapa për në Merdarë, ku atje kanë arritur pa ndonjë incident përafërsisht në ora 19:00.

7. Raporti i zyrtares policore të Policisë së Kosovës, V.Z., i datës 4 prill 2012², thotë:

“Më 04.04.2012, mua mu caktua detyra nga AS-2, që së bashku me njësinë e biçiklistëve (7 zyrtarë policorë dhe 1 polic në veshje civile) të shkojmë në një pikë në Arkivin e Kosovës, pasi që atje do të jetë një delegacion nga Serbia. Me të arritur në zyrat e Arkivit të Kosovës, ne e kontaktuam drejtorin M.M., në lidhje me sigurinë e objektit, sikurse edhe me përfaqësuesin nga zyra e Kryeministrit. Ne biseduam me ata dhe i informuam ata se ne jemi për sigurinë e jashtme të objektit, por me kërkesë të drejtorit, dy policë qëndruan brenda objektit të Arkivit të Republikës së Kosovës. Diku rreth orës 14:00, në Arkivin e Kosovës arriti delegacioni nën përcjelljen e automjetit të Policisë së Kosovës, me të dyja automjetet e delegacionit me tabela të regjistrimit; Shkoda BG-xxx-KS dhe Audi A8 me tabela me nr. BG-xxx-PA, të dyja ato me ngjyrë të zezë, ishin të parkuara në hyrje të Arkivit, dhe të cilat ishin të siguruar nga një numër i mjaftueshëm i

² Dosja e Provave të Prokurorisë në Tab 5 (versioni në gjuhën Angleze).

zyrtarëve policorë, dhe gjatë tërë kohës qëndruan në parking. Diku rreth orës 16:10, kur unë u informova nga njësia e biçiklistëve se delegacioni po përgatitet për tu larguar, unë e dërgova një automjet civil të Stacionit Policor të Jugut deri në rrugën unazore, e cila është në drejtim të zonës së Matiqanit, (pranë EULEX-it), tërë këtë në mënyrë që ta bllokoja rrugën derisa delegacioni të largohet nga zona. Prapa automjeteve të delegacionit ishte një automjet tjetër i policisë së Kosovës me 4 zyrtarë policorë në të. Pasi që u largua delegacioni, unë dhe polici në veshje civile dhe dy zyrtarë policorë në uniforma u nisëm drejt stacionit policor dhe arritëm te hyrja kryesore e QKUK-së. Unë pashë zyrtarë policorë që po vraponin në drejtim të kazermës së quajtur “Hamëz Jashari”. Pasi dola nga automjeti, mua më informuan se në drejtim të automjeteve të delegacionit janë hedhur gurë nga disa meshkuj të cilët ishin mbledhur por që po lëviznin si pasagjerë. Pas kësaj informate, ne u drejtuam drejt Fakultetit Teknik me njërin nga zyrtarët policor i cili ishte në gjendje ti identifikonte të dyshuarit. Kur arritëm te fakulteti teknik, zyrtari policor ishte në gjendje ti dallonte dy të dyshuar, të cilët në ato momente po hynin në një kafiteri, por ishte e qartë se të dy ata ishin të lodhur nga vrapimi. Ne shkuam drejt tyre. Njëri nga ata na vërejti neve dhe filloi të ikte, përderisa ne e arrestuam tjetrin, e shoqëruam atë për në stacion policor, i cili përveç emrit dhe mbiemrit, nuk pranoi të thoshte asgjë tjetër. Kur ne arritëm në stacion e vërejtëm se automjetet e delegacionit ishin aty gjithashtu, dhe një ekip i emergjencës arriti në mënyrë që të ofroj ndihmën mjekësore. Ata nuk e pranuan ndihmën, dhe ishte e qartë se asnjëri nga ata nuk ishte i lënduar. Kur ekipi i emergjencës u largua, njëri nga pjesëtarët e delegacionit kërkoi ta përdorte tualetin, dhe kur u kthye nga aty, ai e preku jakën e maicës me gjak në anën e majtë, dhe ne e vërejtëm se ai e bëri këtë me qëllim, për çfarë ne i informuam përfaqësuesit ndërkombëtar, të cilët gjithashtu ishin të pranishëm, që derisa ai u kthye nga tualeti ai nuk kishte asnjë njollë gjaku. Ne gjithashtu i informuam

përfaqësuesit e qeverisë për veprimet e pjesëtarit të delegacionit të Serbisë. Diku rreth orës 16:15, delegacioni i përcjellë nga 3 automjete policore (në të cilat ishin vendosur delegacioni) sikurse edhe dy kamionë merimanga të policisë të ngarkuara me automjetet e delegacionit, dhe 4 automjete tjera policore, janë përcjellë për në pikën kufitare në Merdarë, pa ndonjë problem. Dhe në ora 19:00, ne arritëm në Merdarë, dhe kur ata e kaluan pikën kufitare të Republikës së Kosovës, ne u kthyem për në Prishtinë”.

8. Raporti i zyrtarit policor të Policisë së Kosovës, G.B, i datës 4 prill 2012³, thotë:

“Sot nga ora 14:00, ne u caktuam në ndërtesën e Arkivit të Kosovës ku po mbahej një takim me një delegacion të palës Serbe. Çdo gjë ishte në rregull në lokacion dhe nuk kishte ndonjë problem që vlen të përmendet. Në ora 16:00 përfundoi takimi dhe delegacioni vazhdoi për në Zyrat Kadastrale të Kosovës, nën përcjelljen e policisë. Në rrugën “Muharrem Fejza”, pranë rreth-rrotullimit, u sulmua konvojit, dhe pasi që ne ishim me automjet zyrtar dhe pasi që kolegu im Xh.H. e njohu përshkrimin e personave, ne vazhduam me kërkimin e tyre. Në rrugën “Agim Ramadani” ne e ndaluam një person i cili po përputhej me përshkrimin dhe së bashku me Rreshterin Sierra Echo 4 (V.Z.), e mbajtëm atë nën kontroll deri sa njësia AS -101 arriti dhe e shoqëroi pësonin e dyshuar për në stacionin policor të jugut. Ne e kaluam ca kohë duke i kërkuar personat [njerëzit] tjerë, por ne nuk ia arritëm ti shohim ata.”

9. Dhe në fund, raporti i zyrtarit policor të Policisë së Kosovës, Xh.H., gjithashtu i datës 4 prill 2012⁴, thotë:

³ Dosja e Provave të Prokurorisë në Tab 6.

⁴ Dosja e Provave të Prokurorisë në Tab 4.

“Sot, më 04.04.2012, prej orës 14:00, unë së bashku me njësitë AS-150, AS-151, AS-152, AS-155 dhe AS-156, ishim duke i siguruar objektet e kadastrit në lidhje me një vizitë të një delegacioni nga Serbia. Rreth orës 16:10, delegacioni u largua nga ndërtesa e kadastrit dhe përderisa ata ishin duke lëvizur në rr. “Muharrem Fejza” dhe kur ne iu afruam rreth-rrotullimit afër hyrjes kryesore të spitalit, papritmas disa njerëz, tre njerëz filluan të hedhin gurë në drejtim të automjeteve me tabela të regjistrimit të Serbisë. Menjëherë njësia jonë filloi ti ndjekë personat e dyshimtë dhe së bashku me AS-150 ne ia arritëm ta ndalojmë njërin nga ata në rr. “Agim Ramadani” te fakulteti teknik. Pas kësaj, AS-101 erdhi dhe e transportoi personin e dyshimtë për në stacion, përderisa ne patrulluam për ca kohë duke i kërkuar personat tjerë, por nuk i pamë ata”.

10. Rrjedhimisht, më 5 prill 2015, polici E.D. nga Policia e Kosovës, e përpiloi një raport të forensikës⁵, i cili thotë:

“Më 04.04.2012, përafërsisht në ora 16:00, në stacion policor janë sjellë dy automjete me tabela të regjistrimit të Serbisë, të cilat ishin shkatërruar tek hyrja e QKUK-së... Ne vazhduam me ekzaminimin e automjeteve të shkatërruara. Në këtë ekzaminim morën pjesë: unë (E.D.), B.B dhe një koleg nga forensika rajonale... Automjetet ishin brenda rrethojës së stacionit policor, dhe të dyja ato ishin të demoluara. Automjeti i parë ishte Shkoda Super b, me tabela BGxxxKS, dhe automjeti i dytë ishte AUDI me tabela BGxxx. Të dyja automjetet ishin të zeza. Automjeti i parë kishte të demoluar në formë gërvishtjeve në pjesën e sipërme (tavan), xhamin e derës së prapme në anën e majtë dhe gërvishtje në derën e parë afër dorezës. Madje kishte gërvishtje edhe në anën e djathtë në pjesën e lartë, përderisa brenda ishin dy gurë, njëri nga ata në ulësen e shoferit dhe guri tjetër në

⁵ Shiko raportin e Njesisë së Forensikës, të datës 05/04/12, Skedari i Provave, Tab 16.

ulësen e prapme në anën tjetër nga ajo e shoferit. Përderisa automjeti i dytë, Audi, i kishte të demoluara të dyja dritaret e dyerve të para dhe brenda në ulësen e shoferit ishte një guri”.

11. Përfundimisht, më 30 shtator 2013, nga atëherë ish zyrtari policor i Policisë së Kosovës, Xh.H., u dha një deklaratë e dëshmitarit Policisë Franceze⁶, në të cilën ai deklaroi:

“Në ditën e ndodhive, unë isha zyrtar policor në Prishtinë. Unë isha në detyrë dhe unë po siguroja një ndërtesë të zgjedhur për një dialog ndërmjet Kosovarëve dhe Serbëve. Në kohën e ndodhive, kur konvoji po largohej nga ndërtesa, unë isha në automjet të policisë për tu kthyer prapa në vendin tim të punës. Unë isha prapa konvojit kur pashë njerëz që po hidhnin gurë në drejtim të konvojit që përbëhej prej dy veturave. Ne ishim pesë zyrtarë policorë në automjetin tonë. Ne e ndalëm automjetin tonë, dhe secili polic vrapoi drejt një individi. Unë, i shoqëruar nga një zyrtar policor, z. G.B. me numër xxx, vrapuam drejt një individi.

Ne e arrestuam një individ dhe e prangosëm atë. Një individ tjetër iku (në arrati). Unë e precizoj që personi i arrestuar ishte i vetmi që u arrestua për këto akuza. Unë jam i sigurt që unë e pashë këtë person duke hedhur gurë në drejtim të konvojit; unë nuk e humba atë nga shikimi im përderisa po vrapoja. Do të shtoja se ne ia dorëzuam këtë individ zyrtarëve tjerë policorë, të cilët e dërguan atë për në stacion policor.

Unë isha prapa konvojit kur ndodhi incidenti. Unë pashë disa njerëz duke hedhur gurë dhe unë vrapova në drejtim të vetëm njërit individ, përderisa nuk i kam parë qartazi individët tjerë. Tani, unë nuk do të mund ta njihja personin e dytë i cili u

⁶ Shiko deklaratat e dëshmitarit Xh.H., të datës 30/09/13, Skedari i Provave, Tab 15, fq. 122-125 ANG., fq. 129-132 SHQIP, fq. 137-138 SERB.

arratis. Unë e arrestova individin rreth 150 metra larg nga konvoji, në rrugën “AGIM RAMADANI”. Kur e arrestuam, ai nuk rezistoi. Unë ia dorëzoja individin zyrtarëve policorë; unë po e kërkoja individin e dytë, por më kot. Unë iu ktheva detyrës sime. Unë nuk e humba nga shikimi individin që unë e kapa. Gjatë kapjes së tij, unë nuk kam folur dhe as individi nuk ka thënë asgjë, përveç «më lësho». Në momentin e kapjes, individi kishte mbetur pa frymë. Unë e pashë shumë mirë se individi që unë e arrestova atëherë, hodhi gurë në dritare të automjeteve; ai qartazi kishte vënë në shënjestër ti godiste dritaret e automjeteve”.

12. Në aktakuzë, prokurori deklaroi se ish zyrtari policor i Policisë së Kosovës, Xh.H., tani banon në xxx, xxx, por ishte një “dëshmitar vendimtar” në këtë rast, dhe kërkoj që ai të dëshmoj në shqyrtim gjyqësor përmes video-lidhjes, nga Franca. Kjo rrjedhimisht është aranzhuar përmes Ndhmës Ndërkombëtare Ligjore me autoritetet përkatëse në Francë, për ndihmën dhe bashkëpunimin e të cilave trupi gjykues është shumë mirënjohës.

Shqyrtimi gjyqësor:

13. Pas disa përpjekjeve të pasuksesshme për ta sjellë të pandehurin në gjykatë, shqyrtimi gjyqësor filloi me një seriozitet të plotë më 15 korrik 2015. Prokurorja e hapi rastin e saj duke deklaruar *inter alia* se në kohën e incidentit, i pandehuri ishte një student dhe pretendohet të ishte një anëtar i partisë politike “*Vetëvendosje*”. Ajo deklaroi se delegacioni Serb që ishte për vizitë përbëhej prej dy avokatëve, një inxhinieri, një këshilltari, një përkthyesi dhe dy shoferëve, dhe ishin në Prishtinë për një takim dy orësh me përfaqësuesit e UE-së dhe të Zyrës Kadastrale të Kosovës, si pjesë e dialogut Prishtinë - Beograd.

14. Prokurorja deklaroi se kur përfundoi takimi, përafërsisht në ora 16:15, delegacioni Serb u largua për në Beograd, me dy (2) automjete zyrtare – një Audi A8 të zezë me tabela të regjistrimit BG-xxxPA, dhe një Shkoda Super B të zezë me tabela të regjistrimit BG-xxxKS, dhe të dyja automjetet i përkisnin Administratës për Shërbime të Përbashkëta të Organeve të Republikës me vendndodhje në Beograd. Konvojit i ishte caktuar një eskortë e Policisë së Kosovës.

15. Prokurorja deklaroi se me arritjen e konvojit në rrugën përpara hyrjes së Qendrës Spitalore të Prishtinës, QKUK, konvoji u sulmua nga individë nga të dyja anët e vendkalimit të këmbësorëve. U hodhën gurë të cilët shkaktuan dëme në automjete, dhe ky akt i pretenduar e krijoi bazën e Pikës 2 të aktakuzës. Prokurorja parashtrroi që policia raportoi se sulmi u krye nga disa individë në rrugë, të cilët dhanë përshtypjen të jenë mbledhur, por në fakt ishin duke ecur si këmbësorë të rastit⁷.

16. Prokurorja deklaroi se menjëherë pas incidentit, policët e Policisë së Kosovës filluan ta patrullonin zonën dhe rrethinën e saj. Disa momente më vonë, policët i dalluan kryerësit, dolën nga automjetet e tyre përkatëse dhe vrapuan pas individëve në fjalë. ajo deklaroi se kjo ndjekje është filmuar dhe më vonë është vendosur në portalin YouTube. Ajo deklaroi se i pandehuri rrjedhimisht është kapur dhe arrestuar në zonën e fakultetit teknik në rr. “Agim Ramadani”; përafërsisht 150 metra nga ku ndodhi incidentit fillimisht. Megjithatë, të dyshuarit tjerë të përfshirë, ia arritën ti shmangen kapjes nga autoritetet.

17. Në ndërkohë, delegacioni Serb është përcjellë nga policët e Policisë së Kosovës për në stacionin policor të jugut, ku delegacioni e raportoi incidentin dhe automjetet u ekzaminuan në mënyrë forensike.

⁷ Deklarata e S. K. 4.4.2012, tab 3

18. Prokurorja parashtroi se incidenti ishte i motivuar nga paragjykimet që ndërlidheshin me përkatësinë etnike të viktimave. Ajo e shprehu besimin e saj se ekzistonte një shkallë e planifikimit që përfshihej në incident, pasi që i pandehuri dhe në tekstin e mëtejme të dyshuarit e panjohur u mblodhën në afërsi të Zyrës Kadastrale në rrugën që ata e dinin që konvoji Serb do ta merrte për tu kthyer për në Beograd, dhe kishin në posedim të tyre gjësende që ata i përdorën për të dëmtuar automjetet, domethënë gurë/tulla të mëdha. Ata e kurdisën deri në perfeksion momentin e caktuar në të cilin ti hedhin gurët/tullat e mëdha, në mënyrë që dëmi i bërë të jetë i lokalizuar. Prokurorja parashtroi se kjo është konfirmuar nga fakti se asnjë automjet tjetër nuk është goditur dhe /apo dëmtuar nga i pandehuri dhe individët tjerë të përfshirë, përveç automjetet që i përkisnin zyrtarëve Serb. Prokurorja parashtroi se i pandehuri dhe të tjerët kishin qëllim të qartë, d.m.th. ti sulmonin dhunshëm përfaqësuesit Serb dhe ti dëmtonin automjetet e tyre. Prokurorja parashtroi se i pandehuri nuk kishte dyshim se pasagjerët e automjeteve ishin persona nën mbrojtje ndërkombëtare.

19. Në deklaratën e tij hyrëse, avokati mbrojtës i atëhershëm i të pandehurit, avokat M.D., deklaroi se klienti i tij e kundërshtoi aktakuzën dhe po deklarohej i pafajshëm. Ai parashtroi se aktakuza ishte e bazuar vetëm në dëshmi të dëshmitarëve, të cilat ishin “*tepër të paqarta*”. Ai deklaroi se klienti i tij është akuzuar në bashkëkryerje, por asnjë bashkëkryerës tjetër që pretendohen të kenë qenë nuk ishin të pranishëm në gjykatë. Ai deklaroi se aktakuza ishte e bazuar në dëshminë e dëshmitarit Xh.H., dëshminë e të cilit ai “*e kontestoi dhe e hodhi poshtë*”. Ai aludoi se ky dëshmitar e ka dhënë dëshminë e tij si kundër-shpërblim ndaj autoriteteve xxx që ta trajtojnë kërkesën e tij për azil në xxx në mënyrë të favorshme. Ai gjithashtu deklaroi se gurët që gjoja se janë hedhur në incident, nuk janë gjetur dhe nuk i janë nënshtruar ndonjë lloj analize forensike. Ai deklaroi se ai

nuk e konteston që automjetet në konvoj janë dëmtuar, por kanë qenë të pranishëm disa njerëz kur ka ndodhur kjo dhe nuk ka mundur të dëshmohet se ka qenë i përfshirë klienti i tij.

20. Dëshmitari i parë që ka dëshmuar në shqyrtimin gjyqësor ka qenë V.Z. Ajo deklaroi se asaj i kujtohet incidenti dhe në atë kohë ajo ka qenë rreshterë në sektorin e pestë të Policisë së Kosovës, në Prishtinë. Asaj i kujtohet ta ketë përpiluar një raport në lidhje me incidentin më 4 prill 2012, dhe që e ka dhënë një deklaratë për Prokurorin e EULEX-it më 25 shkurt 2013. Më 4 prill 2012, ajo është caktuar të shkoj në Zyrën Kadastrale të Kosovës për të ofruar siguri për delegacionin që po vinte për vizitë. Ajo deklaroi se ajo ishte aty me policët nga njësia e motoçiklistëve dhe zyrtarë tjerë policorë. Aty përafërsisht ishin 8 policë gjithsej. Ajo ishte në uniformë. Ajo e përshkroi lokacionin e Zyrës Kadastrale.

21. Rr. V.Z. deklaroi se ajo ishte në dijeni se një delegacion Serb po vinte për vizitë dhe ajo gjithashtu e dinte qëllimin e vizitës së tyre. Ajo deklaroi se ajo ishte e pozicionuar në katin e dytë të Zyrës Kadastrale, por ajo nuk ishte statike dhe ka lëvizur përreth duke i mbikëqyrur zyrtarët policorë në stacionimet e tyre. Ajo ka vazhduar të lëvizte nga një stacionim në tjetrën, por nuk mund të thoshte se a ishte kryesisht brenda apo jashtë.

22. Rr. V.Z deklaroi se policia arriti në Zyrën Kadastrale rreth orës 13:00, dhe delegacioni arriti në ora 14:00. Ajo e përshkroi përbërjen e konvojit Serb. Ajo deklaroi se takimi përfundoi përafërsisht në ora 16:00. Ajo deklaroi se në kohë ajo ishte afër ShP të EULEX-it dhe po e bllokonte trafikun ashtu që delegacioni të mund të lëvizte i papenguar. Ajo deklaroi se ajo nuk e pa sulmin për shkak se rreth-rrotullimi ishte *“i pozicionuar në nivel më të ulët”*. Ajo deklaroi se ajo është informuar për këtë përmes radio-lidhjes shumë shpejt pasi që ka ndodhur.

23. Rr. V.Z deklaroi se ajo hyri në automjet dhe shkoi tek rreth-rrotullimi dhe ajo pa zyrtarët policorë duke vrapuar drejt kazermës “Hamëz Jashari” dhe Ulpianës. Ajo deklaroi se ajo vrapoi gjithashtu *“përmes fakultetit teknik nga pjesa e sipërme në rrugën “Agim Ramadani”*. Ajo deklaroi se ajo ishte me kolegët e saj nga njësia e motoçiklistëve: M.B., Sh.M., dhe H.K...

24. Rr. V.Z. deklaroi se ajo ishte në posedim të përshkrimit të të dyshuarit, të dhënë nga një zyrtar policor i cili ishte në afërsi. Ajo deklaroi *“ne”* ia arritëm ti shohim dy persona, që po hynin në një kafiteri që të cilët ishte e dukshme se po gulçonin dhe që ishin mbushur me frymë. Ajo deklaroi *“ne”* ia arritëm ta ndalojmë njërin nga ata dhe tjetri shkoi tutje drejt banesave të kuqe në Breg të Diellit dhe u fsheh diku aty. Ajo deklaroi që personi që u ndalua është arrestuar sipas informatave të dhëna nga zyrtari policor në afërsi, por ajo personalisht nuk e pa atë duke hedhur gurë. Ajo deklaroi se asaj nuk i kujtohet se cili polic e deklaroi këtë, por mund të ketë qenë M. B. apo Sh.M.. Ajo nuk e dinte dhe nuk mund të thoshte nëse polici që e transmetoi informatën ishte i pranishëm me të kur ajo e arrestoi të dyshuarin.

25. Rr. V.Z. deklaroi se hedhja e gurëve ndodhi në udhëkryq të rrugës hyrëse për në spital dhe rrugës “Fehmi Lladrovci”, dhe *“zyrtarët policorë, sipas pozicionit të vendit, duke qenë në anën e djathtë dhe duke e parë rrugën, dhe unë duke qenë në automjet me një zyrtar policor vazhduam në anën e majtë, duke u drejtuar shkallëve të fakultetit teknik, duke u përpjekur ta mbyllim kalimin dhe kur arritëm në pjesën e sipërme, nuk më kujtohet se cili nga zyrtarët policorë i zuri ata, por ishte njëri nga ngasësit e motoçikletave që po i përcillte automjetet që sihin sulmuar”*. Rr. V.Z. deklaroi se ajo e pa vetëm një të dyshuar duke vrapuar nga kafiteria drejt bllokut të ndërtesave, por ajo deklaroi se ajo e pa atë vetëm nga prapa.

26. Në këtë pikë, Prokurorja ia potencoi Rr. V.Z. se kishte disa mospërputhje ndërmjet dëshmisë së saj dhe asaj që ajo deklaroi përpara Prokurorit të EULEX-it më 25 shkurt 2013. Rr. V.Z. deklaroi se veprimet që i atribuohen policit M.B. në faqet 81 dhe 82 të versionit në gjuhën Angleze të deklaratës së saj për Prokurorin, në vend të kësaj duhej ti atribuoheshin policit A.Rr.

27. Rr. V.Z. deklaroi se ishte njëri nga policët me motoçikleta, i cili deklaroi që të dyshuarit ishin dy personat që po vraponin drejt kafiterisë, por asaj nuk i kujtohej se cili ishte ky polic. Ajo deklaroi se policët me motoçikleta nuk ishin me të kur ata i panë të dyshuarit duke vrapuar, por ata ishin në anën e kundërt dhe ata po vinin drejt njëri tjetrit. Ajo deklaroi *“ata u përpoqën ti arrestonin ata dy, dhe në këtë rast ata ia arritën ta arrestonin zotërinë këtu, përderisa tjetri ia arriti të arratiset duke depërtuar përmes objekteve dhe duke shkuar drejt bllokut atje lart. Dhe unë kërkova që të më sigurohet një automjet për transportim dhe u përkujdesa për sigurinë e personit të arrestuar. Këto ishin veprimet e mia”*.

28. Atëherë Prokurorja ia potencoi dëshmitares se në faqen 5 të versionit në gjuhën Angleze (faqe 82 në dosjen e rastit) të deklaratës që ajo i dha Prokurorit më 25 shkurt 2013, ajo është përgjigjur në një pyetje *“posa ne arritëm tek shkallët e fakultetit teknik, aty ishin dy persona duke u munduar të hynin brenda në kafiteri, dhe ne dolëm nga automjeti. Atëherë njëri nga ata, i cili tashmë kishte hyrë në kafiteri, na pa neve dhe filloi të ikte”*, dhe kjo ishte ndryshe nga ajo çfarë kjo po thotë tani d.m.th. ajo nuk kishte kontakt apo nuk i kishte parë këta individë.

29. Rr. V.Z deklaroi se dëshmia e saj ishte se ajo i pa këta persona kur ajo shkoi tek fakulteti teknik, dhe kur ata u ndaluan nga njësia e motoçiklistëve, njëri u ndal dhe tjetri iku tutje me vrap. Ajo shtoi *“Ne u kthyem te veturat, vazhduam tutje, në*

të vërtetë unë jo, por vetëm ata, po kjo ishte në ndjekje të personit të dytë. Një tjetër automjet erdhi dhe e mori atë dhe ne e vazhduam edhe më tutje ndjekjen”.

30. Rr. V.Z deklaroi se asaj nuk i kujtohej nëse ndonjëri nga të dyshuarit ka thënë ndonjë gjë në kafiteri. Prokurori ia potencoi asaj se në faqen 5 të versionit në gjuhën Angleze të deklaratës së saj dhënë Prokurorit më 25 shkurt 2013, ajo kishte deklaruar: *“Njëri nga ata ka hyrë në kafiteri. Ai na pa neve dhe filloi të ikte tutje duke thirrur “policia” dhe H. dhe A., nuk jam e sigurt, filluan ta ndjekin atë”*. Rr. V.Z. deklaroi se i kujtohet kur personi u arratis dhe kur ai u ndalë, por jo kur ai është arrestuar dhe prangosur, por ajo deklaroi se ajo qëndroi me të në mes të dy automjeteve civile.

31. Rr. V.Z. deklaroi se njëri nga të dyshuarit iku nga kafiteria përderisa i pandehuri ndaloi te kafiteria, brenda apo në derë, por ajo nuk ishte e sigurt se ku. Ajo deklaroi se ajo e vuri nën kontrollë këtë person dhe ai kishte mbetur pa frymë. Ajo deklaroi se ajo kërkoi transportim për të, që më vonë erdhën, por ajo nuk mund të thoshte se për sa kohë ajo ishte me të. Ajo deklaroi se ky person ishte i pandehuri **K.D.**. Megjithatë, ajo deklaroi se në asnjë moment ai nuk e përmendi se ai kishte ndonjë lëndim. Asaj nuk i kujtohej se a kanë bërë ata ndonjë lloj bisede. Asaj nuk i kujtohej se a kishte ai ndonjë lëndim apo madje edhe se a e ka shoqëruar ajo atë për në stacion policor. Ajo u pajtua se raporti i saj thotë se ajo e bëri këtë. Asaj iu kujtua se ishte një ambulancë në stacion policor, por asaj nuk i kujtohej se a i ishte nënshtruar i pandehuri ndonjë trajtimi mjekësor aty.

32. Duke iu përgjigjur pyetjeve nga M.D, avokati mbrojtës i të pandehurit, dëshmitarja Rr. V.Z. deklaroi se ajo dëgjoi se sulmi ndodhi në mes të rrugës hyrëse për në spital dhe rreth-rrotullimit për në rr. “Fehmi Ramadani” (sic!). Ajo deklaroi që rruga që e lidh këtë rreth-rrotullim me një rreth-rrotullim tjetër me një flamur të

madh të Kosovës, është rruga “Fehmi Lladrovci”. Ajo deklaroi se i pandehuri është arrestuar duke hyrë në kafiteri. Ajo deklaroi se ajo nuk ishte përgjegjëse për bllokimin apo sigurimin e rrugëve. Ajo deklaroi se ishte çështje e sekondave prej momentit kur i pandehuri në të vërtetë është kapur e deri te momenti kur ajo ka arritur.

33. Në përgjigjen e pyetjes nga trupi gjykues, dëshmitarja Rr. V.Z. deklaroi se me sa i kujtohet asaj, delegacioni Serb është përcjellë nga njësia e policisë me motoçikleta, dhe nuk ishin raportuar probleme gjatë takimit të tyre. Ajo deklaroi se kur ajo arriti në pikën ku ishte kapur i pandehuri **K.D.**, e vetmi tipar i rëndësishëm fizik që ajo kishte vërejtur ishte që ai po frymonte shpejt. Ajo deklaroi se radio-lidhje e policisë tregoi se ishin së paku tre kryerës të përfshirë në sulm dhe ajo e dëgjoi përshkrimin e veshjeve të të dyshuarve, por asaj nuk i kujtohej tani. Megjithatë, ajo ishte e sigurt se i pandehuri **K.D.** kishte veshur veshje që përputheshin me përshkrimin. Ajo deklaroi se përshkrimi ishte dhënë nga policët e njësisë së motoçiklistëve. Ajo deklaroi se aty kishte “*plot njerëz*” në kafiteri kur i pandehuri ishte kapur, por nuk kishte shumë jashtë. Ajo deklaroi se ia pandehuri ishte ndaluar nga njësia e motoçiklistëve përderisa ai ishte duke hyrë në kafiteri. Ajo deklaroi se asaj i kujtohej një polic nga njësia e motoçiklistëve duke thënë “*ky është ai, shoku i tij iku tutje*”.

34. Gjyqtarja Witteman ia potencoi dëshmitares se ajo më parë e kishte përmendur policin M.B. si atë që e kishte identifikuar të pandehurin. Dëshmitarja deklaroi se ajo nuk ishte e sigurt, por ajo tani besoj se në fakt ishte polici Xh.H. ai i cili i pa personat duke hedhur gurë. Ajo deklaroi se polici M.B. i tha asaj se ishte polici Xh.H.. Megjithatë, ajo gjithashtu deklaroi se pasi që njësia e motoçiklistëve të gjithë kishin helmata, ishte e vështirë ti dalloje njërin nga tjetri.

35. Duke iu përgjigjur pyetjes nga i pandehuri **K.D.**, dëshmitarja deklaroi se hera e parë që ajo e kishte parë atë më datën 4 prill 2012 ishte kur ai ishte arrestuar nga kolegët e saj. Ajo deklaroi se ajo ishte shumë afër në atë moment. Ajo deklaroi se i pandehuri nuk kishte ndonjë lëndim të dukshëm në këmbë të tij dhe ai as nuk u ankua për ndonjë lëndim atëherë aty e as në stacion policor. ajo e mohoi se ajo është marrë me të në ndonjë kapacitet në stacion policor dhe në veçanti që ajo e ka keqtrajtuar atë dhe që i kërkoi emrat e të tjerëve të përfshirë në sulm.

36. Dëshmitari i parë që dëshmoi përpara trupit gjykues në seancën e datës 16 korrik 2015 ishte D.P... Ai i dha një deklaratë Policisë së Kosovës më 4 prill 2012. Ai e konfirmoi praninë e tij më 4 prill 2012 në Prishtinë, si pjesë e delegacionit Serb. Ai i përmendi emrat e anëtarëve të delegacionit dhe automjete me të cilat po udhëtonin ata. Ai deklaroi se konvoji është përcjellë nga Policia e Kosovës prej kufirit në Merdarë. Ai deklaroi se mesa i kujtohet atij, ishin dy automjete tereni (SUV) të Policisë së Kosovës, një përpara konvojit Serb dhe një prapa tij.

37. D.P.. deklaroi se ai ishte i ulur në ulësen e përparme të pasagjerit të automjetit të tij dhe ishin dy pasagjerë prapa. Gjithashtu ishte edhe shoferi. Ai deklaroi se udhëtimi prej Merdarit kaloi mirë dhe takimi zgjati ndërmjet një ore e gjysmë dhe dy orëve. Ai deklaroi se kur po largoheshin nga Zyra Kadastrale ishte vetëm një automjet i Policisë së Kosovës përpara konvojit. Ai deklaroi se konvoji u sulmua jo më shumë se dy minuta pasi që u largua nga Zyra Kadastrale, dhe sulmi ndodhi te rreth-rrotullimi.

38. D.P.. deklaroi se ai i pa disa nga fytyrat e njerëzve që hodhën gurë, por ai nuk mund ti identifikonte ata përtej dyshimit të arsyeshëm. Ai deklaroi se nuk mund të ishte i sigurt sesa njerëz ishin të përfshirë në këtë incident, por dukej sikur ishin tre.

Ai deklaroi se një automjet tjetër i Policisë së Kosovës arriti shpejt në vend të ngjarjes.

39. Në lidhje me kryerësit e pretenduar të sulmit, D.P.. deklaroi se incidenti ndodhi para tri viteve, por me aq sa këtij i kujtohet ishin dy persona meshkuj përfaqësues 1.80cm, i moshës së përafërt 25-30 vjeçare dhe me ndërtim trupi mesatar. Ai deklaroi se personi i tretë gjithashtu ishte mashkull dhe ai ishte pak më i shkurtër sesa dy të tjerët dhe pak më i plotë. Ai deklaroi se tre keqbërësit i sulmuan automjetet nga drejtime të ndryshme dhe kjo ka rrjedhur nga fakti se automjetet janë goditur në anët e majta dhe djathta, dhe një person erdhi nga prapa.

40. D.P.. deklaroi se personi që e goditi dritaren e shoferit ishte në një distance prej 1 deri 1.5 metra. Ai deklaroi se atij i kujtohet një person duke vrapuar me një gurë në dorë dhe ai kishte fytyrë të indinjuar. Ai nuk mund të thoshte nëse ndonjëri nga këta individë ka bërë apo klithur. Ai deklaroi se ai beson se diku pesë apo gjashtë gurë e kanë goditur automjetin e tij, duke thyer kështu dritaret dhe dëmtuar karrocerinë. Ai deklaroi se një apo dy gurë hynë në automjet. Ai deklaroi se një guri hyri përmes dritares së prapme të anës së djathtë dhe fluturoi 1 mm. larg syrit të znj. A., e cila ishte e ulur prapa. Ai deklaroi se një guri tjetër ishte i formësuar si ve e strucit dhe pas thyerjes së dritares, ra përpara tij. Dhe pas arritjes në stacion policor ai e vërejti se koka e tij ishte prerë, por ai supozoi se kjo është shkaktuar nga xhamat që kanë fluturuar pasi që guri nuk e kishte goditur atë. Ai deklaroi se disa nga kolegët e tij pësuan lëndime sipërfaqësore, por jo serioze. Ai deklaroi se ai iu nënshtrua trajtimit mjekësor në stacion policor dhe kur u kthye në Serbi, por lëndimi i tij në kokë nuk ishte serioz. Ai deklaroi se në kohën e sulmit brenga e tij ishte për pasagjerët femra dhe që ti largojë ato nga aty në mënyrë të sigurt, pasi që ai u frikësua për jetët e tyre.

41. D.P.. deklaroi se me sa i kujtohet atij, ai ishte i ulur në automjetin e parë të konvojit kur u larguan, por edhe automjeti i dytë ishte sulmuar gjithashtu. Ai deklaroi se ai i takoi kolegët e tij nga automjeti i dytë në stacion policor, pas sulmit. Ai deklaroi se atmosfera në mesin e kolegëve të tij aty ishte ajo e frikës dhe mosbesimit. Ai deklaroi se ai nuk mendoi se ishte e përshtatshme për të që të spekuloj për motivin e incidentit. Ai deklaroi se ai ishte i vetëdijshëm për tensionet në ajër në atë ditë, por asnjë incident si ky nuk kishte ndodhur më parë.

42. Duke iu përgjigjur pyetjes nga avokati mbrojtës i të pandehurit **K.D** avokatit M.D., D.P. deklaroi se ai ishte në automjetin Shkoda “SuperB”. Ai deklaroi se ai nuk ishte i vetëdijshëm për ndonjë protestë nga njerëzit, në afërsi të Zyrës Kadastrale. Ai tha se ai nuk mund të thoshte se a ishte në dijeni ai se a kishte ndonjë person në afërsi të përgatitur për ta sulmuar konvojin. Ai deklaroi se keqbërësit vrapuan drejt konvojit. Ai deklaroi se njëri u afrua nga ana e djathtë, një nga ana e majtë dhe një nga prapa. Ai deklaroi se ai nuk mund ta identifikonte të pandehurin **K.D** si njërin nga keqbërësit. Në përgjigje ndaj pyetjes nga trupi gjykues, D.P. deklaroi se ai nuk e pa se në cilin drejtim u larguan keqbërësit nga vendi i ngjarjes.

43. Dëshmitari i radhës për të dëshmuar përpara trupit gjykues, më 16 korrik 2015, ishte zyrtari policor M.B... Ai e konfirmoi se ai i kishte dhënë një deklaratë Prokurorit të EULEX-it më datën 25 shkurt 2013. Ai e konfirmoi përmbajtjen e deklaratës.

44. Në kohën e incidentit, ai ishte pjesë e njësisë së motoçiklistëve nga stacioni policor i jugut në Prishtinë. Detyra e tij në atë ditë ishte ta siguroj ndërtesën e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Ai i ishte caktuar një automjeti 4x4 dhe ishte në uniformë.

45. Polici M.B.. deklaroi si ai e mori detyrën pas orës 16:00, por nuk i kujtohet kur saktësisht. Ai deklaroi se takimi në ndërtesë përfundoi diku pas orës 16:00. Ai deklaroi se delegacioni Serb u largua nga ndërtesa i përcjellë nga njësia e motoçiklistëve, të cilët u larguan pas tyre, dhe automjeti i tij vazhdoi menjëherë pas këtyre. Ai deklaroi se ai ishte i shoqëruar në automjet nga zyrtari policor i Policisë së Kosovës, Sh.M... Policin M.B.i është treguar deklarata e tij e mëhershme, në të cilën ai kishte deklaruar se në automjet ishin: “*unë, Sh., A. dhe H.*”, dhe ai u pajtua se kjo është e saktë, por ai nuk mund të thoshte se në cilat ulëse në automjet ishin të ulur secili nga kolegët e vet. Ai deklaroi se automjeti i tyre është përcjellë nga një automjet i pa-markuar i Policisë së Kosovës. Ai deklaroi besimin e tij që në këtë automjet kanë qenë Rreshter Vjosa Zeqiri, V.Z., G.B.dhe Xh.H..

46. Polici M.B. deklaroi se aluzioni i tij i parë se diçka nuk është në rregull i erdhi tek rreth-rrotullimi, ku ai dëgjoi zëra që ngjasonin me diçka që po thyhej. Ai tha se ai dhe kolegët e tij i vërejtën tre meshkuj në anën e djathtë të rrugës, përafërsisht 70 deri 80 metra larg. Ai deklaroi se shoferi e ndali automjetin dhe pasagjerët filluan ndjekjen. Ai deklaroi se një mashkull shkoi në drejtim të “Ulpianës” dhe dy shkuan në drejtim të fakultetit teknik. Ai deklaroi që kur ai i vërejti për herë të parë meshkujt, ata ishin duke hedhur tutje diçka që dukeshin të jenë gurë. Ai deklaroi që meshkujt nuk ishin të vjetër dhe se ishin të moshës së përafërt ndërmjet 20-30 vjeçare. Ai deklaroi se ata kishin të veshura veshje normale, jo të veçanta. Ai deklaroi se ai nuk ishte i sigurt se ata po hedhin gurë, por kjo i është konfirmuar atij kur ai i pa gurët në veturë në stacion policor.

47. Polici Maliq Berisha deklaroi se ai vet, “*H. dhe A.*” filluan ndjekjen menjëherë për ti kapur meshkujt, dhe Shemsi vazhdoi me përcjelljen e delegacionit me veturën. Ai tha se meshkujt po vraponin shumë shpejt dhe nuk mund të kapeshin.

Ai tha se ai nuk e vërejti asnjë nga meshkujt të kenë qenë në vështirësi fizike në atë kohë. Ai deklaroi se ai dhe A. u kthyen në lokacion të incidentit, por ai mendoi se H. vazhdoi me ndjekjen. Ai deklaroi se rrjedhimisht ai e dëgjoji në radio-lidhje se njëri nga keqbërësit është kapur. Ai deklaroi se ai e kuptoi më pastaj në stacion policor që polici që e ka kryer arrestin ka qenë Xh.H.

48. Kryetarja e trupit gjykues ia potencoi policit M.B. se në faqen 63 të versionit në gjuhën Angleze, të deklaratës së tij dhënë Prokurorit, ai i përmendi dy emra që e arrestuan keqbërësin, “Xh. dhe G.”. Polici M.B. deklaroi se ndoshta Rr. V.Z. ishte me ta gjithashtu dhe ai nuk mund të ishte i sigurt për shkak se ajo çfarë ai deklaroi ishte e bazuar në bisedat që ai kishte me kolegët e vet, në stacion policor.

49. Ai deklaroi që A. ishte me të në automjet dhe Xh.H. ishte në një automjet të pamarkuar në Zyrën Kadastrale. Ai deklaroi se Xh.H. gjatë asnjë faze nuk ka udhëtuar në të njëjtin automjet me të.

50. Polici M.B. deklaroi se atij nuk i kujtohej emri i personit që është arrestuar apo në cilin stacion policor është dërguar ai. Ai e konfirmoi se ai kishte biseduar me Rreshter V.Z në lidhje me incidentin.

51. Prokurorja ia potencoi policit M.B. që Rr. V.Z. kishte thënë se në të vërtetë një person tjetër e kishte arrestuar të dyshuarin, por polici B. më vonë i tha asaj se në të vërtetë ishte Xh.H. ai që e arrestoi atë. Polici M.B. u përgjigj se Rreshter V.Z. ishte gabim kur ajo i deklaroi Prokurores se ai e kishte kryer arrestimin dhe ai ia kishte qartësuar Prokurores se ishte Xh.H. ai që në të vërtetë e kishte kryer atë. Më pastaj në sallë të gjyqimit është lëshuar një video-filmim i incidentit që rrjedhimisht është vendosur në YouTube. Polici M.B. deklaroi se e paraqiste atë të parin në ndjekje e sipër, dhe pas tij A. dhe H.. Ai deklaroi se i paraqet dy meshkuj duke vrapuar në drejtim të fakultetit dhe tjetrin në drejtim të “Ulpianës”.

52. Duke u përgjigjur në pyetjen nga avokati mbrojtës i të pandehurit K.D., avokatit M.D., polici M.B. deklaroi se ai nuk mund të thotë se a ka qenë K.D. njëri nga tre meshkujt që ai e ka parë duke vrapuar nga vendi i ngjarjes. Ai nuk e kontestoi pohimin e tij të mëhershëm bërë Prokurorit që meshkujt ishin 15 metra larg, përderisa tani ai po thoshte 80 metra, dhe ai deklaroi se për shkak se ka kaluar një kohë e gjatë që prej incidentit, ai nuk mund të ishte i sigurt se cila ka qenë distanca e vërtetë. Megjithatë, ai u pajtua se incidenti me gjasë do të ishte më i freskët në memorien e tij në shkurt të vitit 2013 sesa në korrik të vitit 2015. Polici M.B. deklaroi se ai i pa dy nga tre keqbërësit në anën e djathtë të rreth-rrotullimit, dhe me të dalë nga automjeti, ai e pa të tretin duke vrapuar në drejtim të “Ulpianës”.

53. Gjyqtarja Witteman ia potencoi dëshmitarit se kishte deklaruar se vetëm një person është arrestuar dhe vetëm tani atij i është kujtuar se ishte arrestuar edhe një person apo persona tjerë. Polici M.B. deklaroi se ai nuk e dinte se ku ishte arrestuar ky person, por ai e dinte se një person është arrestuar si i dyshimtë. Ai gjithashtu deklaroi se polici Xh.H. nuk ishte me grupin e tij në automjet apo afër vendit të ngjarjes në kohën e incidentit, pasi që ai duhej të arrinte më vonë. Polici M.B. u pajtua me Gjyqtaren Witteman se nga pozicionet e tyre, as Xh.H., as Rr. V.Z. dhe as polici G.B. nuk mund ti shihnin sulmuesit.

54. Polici M.B. u pajtua me Gjyqtaren Witteman se ai ia kishte dhënë deklaratën Prokurorit në të njëjtën ditë sikurse edhe Rr. V.Z. Ai deklaroi se ata u takuan në stacion policor pasi që ajo e kishte dhënë deklaratën e saj, dhe ajo e informoi atë se ai do të thirret nga Prokurori për të dhënë deklaratë, pasi që ai tha se ishte ky ai që e kreu arrestin. Megjithatë, polici Berisha deklaroi se ai e përmirësoi Rr. V.Z. në këtë pikë dhe e konfirmoi se ishte polici i atëhershëm Xh.H. ai që e kreu arrestin.

Megjithatë, ai atëherë tha se nuk mund të ishte i sigurt se a është bërë kjo bisedë personalisht apo përmes telefonit, por ai ishte i sigurt që ata kishin folur.

55. Prokurorja atëherë ia potencoi policit M.B. se dëshmia e tij tani ishte se polici Xh.H. nuk ishte në vend të ngjarjes në kohën kur ndodhi incidenti. Ai u pajtua me këtë. Prokurorja deklaroi se në deklaratën e tij të datës 25 shkurt 2013, polici Berisha deklaroi se policët H. dhe G.B e kishin kryer arrestin dhe sipas të gjitha gjasave e kanë parë të pandehurin duke hedhur gurë, por tani po thoshte se ata nuk ishin në vend të ngjarjes kur ndodhi incidenti, por erdhën vetëm pas incidentit. Polici M.B deklaroi se ai nuk mund ta shpjegonte këtë tani.

56. Dëshmitari i radhës që dëshmoi përpara trupit gjykues më datën 16 korrik 2015, ishte zyrtari policor i Policisë së Kosovës, Sh. K. Ai gjithashtu më 4 prill 2012 parashtrijoi një raport në lidhje me incidentin. Ai deklaroi se ati i kujtohet ta ketë dorëzuar raportin dhe ai qëndroi prapa përmbajtjes së tij.

57. Polici Sh.K deklaroi se në kohën e incidentit ai ishte pjesë e Njësisë së Policisë së Kosovës, përgjegjëse për përcjelljen e delegacioneve të posaçme. Ai deklaroi se në atë ditë ai e mori delegacionin Serb në Merdarë. Ai deklaroi se udhëtimi për në Prishtinë ishte i qetë. Ai po voziste një automjet me kolegun e tij A.S... Polici Sh.K. deklaroi se ai e përcolli delegacionin për të takimin e tyre dhe u largua, por se ishte i përcaktuar që të kthehej në ora 16:00.

58. Kur u kthyen, polici Sh.K. deklaroi se automjeti i tij ishte i pari në konvojin që e shoqëronte delegacionin Serb. Në konvoj nuk kishte automjete tjera me shenja të policisë. Ai deklaroi se incidenti i hedhjes së gurëve ndodhi përafërsisht 2 deri 3 minuta pasi që konvoji u largua nga Zyra Kadastrale. Ai deklaroi se e dëgjoi kolegun e tij të ketë thënë: “sulm”, përderisa ai vazhdoi më shpejt me delegacionin për të arritur në një vend të sigurt. Ai deklaroi se ai nuk e pa asnjë individ afër

veturës pasi që ai ishte duke e hapur rrugën për automjetet tjera. Ai deklaroi se automjeti Serb ishte afër automjetit të tij që po printe, siç ishte edhe praktika. Ai deklaroi se konvoji është sulmuar nga një “grup i njerëzve”, të cilët në deklaratën e tij të bërë në atë kohë, ai e vlerësoi të ketë qenë ndërmjet 5 deri 7 personave.

59. Polici Sh.K. deklaroi se ashtu siç përshpejtoi ai për të ikur, ashtu bënë edhe delegacioni Serb, dhe ata vazhduan për në oborrin e stacionit policor numër 4, në Lakërishtë. Ai deklaroi se kolegu i tij e nxori kokën jashtë dritares për të parë se çfarë po ndodhte.

60. Kur arritën, polici Sh.K. deklaroi se delegacioni Serb e refuzoi ndihmën e parë nga institucionet Kosovare. Ai deklaroi se ai e informoi Njësinë përkatëse të Policisë së Kosovës për tu marrë me dëmet në automjete dhe gjithashtu i shtyrë nga kureshtja i inspektoi ato edhe vet. Ai deklaroi se ai nuk pa ndonjë lëndim fizik. Ai deklaroi se të dyja automjetet pësuan dëme në xhama dhe në karroceri. Ai deklaroi se më vonë konvoji vazhdoi për tu kthyer prapa në Merdarë. Automjeti i tij e udhëhoqi konvojin prej 5 deri 6 automjete dhe nuk pati incidentet tjera.

61. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga avokati M.D., avokat mbrojtës i të pandehurit K.D., polici Sh.K deklaroi se asnjë anëtarë i delegacionit Serb nuk po gjakoste pas incidentit, kur ishin në stacion policor.

62. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga Gjyqtarja Witteman, polici Sh.K deklaroi se më pastaj ai dëgjoi se ishin arrestuar 2 apo 3 persona në lidhje me incidentin, por ai nuk mund të ishte i sigurt për këtë.

63. Dëshmitari i radhës që dëshmoi përpara trupit gjykues më datën 16 korrik 2015 ishte zyrtari policor i Policisë së Kosovës, G.B... Ai gjithashtu më datën 4 prill 2012 parashtrroi një raport në lidhje me incidentin. Ai deklaroi se atij i kujtohet ta

ketë dorëzuar raportin. Ai gjithashtu e konfirmoi se ai i dha një dëshmi Prokurorit më datën 27 shkurt 2013. Ai deklaroi se ai qëndron prapa përmbajtjes së raportit dhe dëshmisë së tij më pastaj.

64. Polici G.B.. deklaroi se ai ishte punësuar si zyrtar policor që prej vitit 2002, dhe në kohën e incidentit ai ishte duke punuar në njësinë e motoçiklistëve që ishte pjesë e stacionit policor të jugut, në lagjen e Dardanisë. Ai deklaroi se njësia e tij ishte dërguar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për ta siguruar ndërtesën. Ai deklaroi që njësia arriti në ora 14:00 – përpara delegacionit. Ai deklaroi se nuk kishte probleme kur arriti delegacioni. Ai ishte pozicionuar jashtë Agjencisë Kadastrale të Kosovës me disa kolegë, por nuk e mbante mend se cilët saktësisht. Ai deklaroi se ata lëviznin përreth objektit për tu përkujdesur për sigurinë e objektit. Polici G.B.. deklaroi se kur përfundoi takimi, fillimisht njësia qëndroi në Agjencinë Kadastrale të Kosovës derisa arritën njësitë tjera për të ofruar transportin për në stacion.

65. Polici G.B.. deklaroi se njësia e tij mbeti në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për një periudhë të shkurtë kohore derisa arriti një automjet i policisë i cili ishte i pa markuar. Ai deklaroi se atij nuk i kujtohet se kush udhëtoi në veturë me të, por ai mendon se ishin 4 deri 5 policë, të cilët me aq sa i kujtohet, të gjithë ishin në uniforma.

66. Polici G.B.. deklaroi se ai nuk e pa sulmin në delegacion, por dëgjoi për të në radio-lidhje të policisë. Ai deklaroi se një koleg i cili mund ta identifikonte njërin nga sulmuesit erdhi te automjeti dhe së bashku me të, dhe duke u bazuar në përshkrimin e tij, njësia më pastaj ishte në gjendje ta kapte të pandehurin K.D.. Ai deklaroi se kolegu ishte polici Xh.H.. Ai deklaroi se polici Xh.H. ishte në rrethrotullimin afër spitalit përpara se të vinte te automjeti i policit B.

67. Polici G.B. deklaroi se kaluan përafërsisht 2 deri 3 minuta nga koha kur polici Xh.H. hyri në automjet e deri sa ai e pa të dyshuarin. Ai deklaroi se kur polici H. hyri në automjet, ata udhëtuan në drejtim të fakultetit teknik. Ai deklaroi se Xh.H. gjithashtu hyri në automjet dhe një koleg doli, duke i bërë kështu gjithsej pesë pasagjerë. Ai deklaroi se polici Xh.H. e identifikoi të pandehurin **K.D.** në prani të tij, përderisa ai ishte duke hyrë në një kafiteri. Ai deklaroi se ata të gjithë dolën nga automjeti. Ai deklaroi se i dyshimti është kapur në njërin nga kafiteritë përballë fakultetit teknik, dhe kjo ishte përafërsisht 100 deri 200 metra larg nga vendi i incidentit. Ai deklaroi se i dyshuari ishte me një person tjetër në kohën kur ata po ecnin së bashku drejt kafiterisë dhe hynë në të. Ai deklaroi se policët hynë në kafiteri dhe iu afruan këtyre personave dhe iu kërkuan atyre të dalin jashtë, por kur ata dolën, njëri nga ata iku dhe i pandehuri **K.D.** është kapur. Ai deklaroi që polici Xh.H. e kishte njohur atë nga automjeti. Ai deklaroi se ai e kishte vështruar atë duke e kaluar rrugën dhe ai po ecte normalisht. Kur u kap, ai deklaroi që i dyshuari ishte nervoz, por bashkëpunues. Ai nuk tha apo bëri asgjë. Polici G.B deklaroi se ai personalisht nuk e arrestoi të pandehurin, por ai e vëzhgoi këtë dhe mori pjesë në të. Ai deklaroi që pas arrestimit, i dyshuari është dërguar me veturë të policisë për në stacion policor dhe ai nuk është marrë më tutje me të apo me delegacionin Serb për sa i takon.

68. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga avokati M.D., avokat mbrojtës i të pandehurit **K.D.** polici G.B deklaroi se njësia udhëtoi përmes rrugës “Muharrem Fejza”, pastaj u kthye djathtas për në rrugën “Fehmi Lladrovci”, dhe pastaj prapë u kthye djathtas për në rrugën që ai beson se ishte rruga “Agim Ramadani”, dhe kjo shpiti te kafiteria ku është arrestuar i pandehuri. Ai deklaroi se pas arrestimit i pandehuri nuk është mbajtur për shumë kohë jashtë kafiterisë, por vetëm derisa ka ardhur një veturë e markuar e policisë për ta transportuar atë për në stacion policor. atij nuk i

kujtohet se cilët zyrtarë policorë kanë qëndruar me të derisa ka ardhur vetura, dhe rrjedhimisht ai nuk ka udhëtuar në veturë të policisë me të dyshuarin.

69. Polici G.B. deklaroi se ai nuk e ndoqi të dyshuarin e cili iku, pasi që kjo mund të qonte deri te ikja e njërit nga të dyshuarit që njësia ia kishte arritur ta kapte. Ai e konfirmoi se ai ishte në të njëjtën njësi sikurse edhe polici Xh.H. dhe detyra e tij ishte që ta siguroj ndërtesën.

70. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga Gjyqtarja Witteman, polici G.B. deklaroi se polici Xh.H. më herët ka qenë në një automjet tjetër dhe me gjasë ai ka pasur mundësinë ta shoh sesi është zhvilluar incidenti, dhe për këtë ka mundur ta identifikoj personin duke u bazuar në pamjen e tij fizike. Polici B. deklaroi se ai nuk mund të thoshte përse polici H. ka mundur ta identifikoj vetëm një të dyshuar. Megjithatë, ai deklaroi se polici H. ishte në gjendje të thotë që i dyshuari kishte mjekër. Polici G.B. deklaroi se ai në asnjë kohë nuk e pa ndonjë të dyshuar duke vrapuar nga vendi i ngjarjes. Më vonë ai nuk ka dëgjuar nëse është kapur edhe ndokush tjetër.

71. Në përgjigjen ndaj një pyetjeje nga kryetarja e trupit gjykues, polici G.B. deklaroi se ai punoi në të njëjtën njësi sikurse polici M.B dhe Rr. V.Z ishte udhëheqëse e ekipit. Ai deklaroi se ai nuk ishte i sigurt se a ka qenë me ata kur ka ndodhur sulmi. Ngjashëm, ai nuk mund të shpjegonte përse atij iu kujtua tani që polici Xh.H. ta ketë përshkruar të dyshimtin të ketë pasur mjekër, por jo kur ai është intervistuar nga prokurori në vitin 2013.

72. Trupi gjykues mori dëshminë nga ish zyrtari policor i Policisë së Kosovës, Xh.H. më 1 shtator 2015, përmes video-lidhjes nga gjykata e qarkut të Rennes në Francë. Dëshmitari dha dëshminë në prani të nëpunëses së Gjykatës znj. Nathalie

Romairë, dhe në fillim të seancës ajo e konfirmoi që dëshmitari e ka identifikuar veten siç është e paraparë.

73. Xh.H. deklaroi se atij i kujtohet incidenti dhe raporti që ai e ka dorëzuar në të njëjtën datë. ai e konfirmoi se edhe ai gjithashtu i dha një deklaratë Rreshterit të Policisë Raoul Riou, më datën 30 shtator 2013. Ai deklaroi se qëndroi prapa përmbajtjes së raportit të tij të datës 4 prill 2012. Megjithatë, deklarata e datës 30 shtator 2013 nuk është marrë në prani të përkthyesit të certifikuar, por vetëm një personi që mund të fliste në gjuhën Shqipe dhe Franceze.

74. Xh.H. deklaroi që në kohën e incidentit ai ishte zyrtar policor në njësinë e motoçiklistëve, stacioni policor i jugut në Prishtinë. Në ditën e incidentit ai ishte në uniformë dhe detyra e tij ishte të ofroj siguri të jashtme në Zyrën Kadastrale të Kosovës. Ai qëndroi jashtë ndërtesës për t'ua parandaluar qasjen personave të paautorizuar. Ai deklaroi se ai tashmë ishte në këtë pozicion përpara se të arrinte delegacioni Serb. Ai deklaroi se të gjithë shtatë pjesëtarët e njësisë së motoçiklistëve ishin të pranishëm. Ata kishin arritur aty me automjet zyrtar të policisë. Ai deklaroi se ai e pa delegacionin Serb të arrinte. Ai deklaroi se ishin dy automjete që përcilleshin nga një automjet SUV i Policisë së Kosovës. Ai deklaroi se në këtë pikë ai ishte përafërsisht 20 deri 30 metra larg nga dera kryesore e ndërtesës.

75. Xh.H.. deklaroi se ai ende ishte në të njëjtin lokacion kur delegacioni Serb u largua nga ndërtesa, përafërsisht në ora 16:00. Dy automjetet e delegacionit prapë po përcilleshin nga një automjet i Policisë së Kosovës. Ai deklaroi se ai e informoi zëvendës komandantin e tij, policin B.B., dhe ai ishte liruar nga detyra. Ai deklaroi se gati menjëherë ai vazhdoi në drejtim të qytetit dhe stacionit, në ulësen e prapme (në mes) të një Golf 5 të markuar, të vozitur nga polici Sh.M. dhe i shoqëruar nga

A.S. dhe G.B... Ai deklaroi se ishte edhe polici i pestë i pranishëm, por ai nuk mund të thoshte se a ka qenë ky polici V.P. apo polici M.B... Ai deklaroi se ata ishin përparësisht 100 metra prapa konvojit, por u afruan më shumë deri në kohën kur këta arritën në udhëkryqin me rrugën “Fehmi Lladrovci”. Ai deklaroi se ai mund ta shihte konvojin qartazi edhe pse kishte automjete tjera ndërmjet tyre. Ai deklaroi se policia nuk i kishte bllokuar asnjë nga rrugët që kanë qasje në rreth-rrotullim. Ai deklaroi se kur automjetet e delegacionit Serb arritën në rreth-rrotullim, automjeti i tij ishte më pak se 10 metra prapa tyre. Atij nuk i kujtohet se a ka pasur automjete ndërmjet tyre, por ai deklaroi se sidoqoftë ai kishte pamje të qartë të asaj se çfarë po ndodhte përpara tij.

76. Prokurori atëherë ia tregoi Xh.H.. t një hartë të një zone dhe ia potencoi Zyrën Kadastrale të Kosovës të shënuar “*Arkivi i Kosovës*”. Ai gjithashtu tregoi me gisht në rreth-rrotullim dhe “*Fakulteti Teknik*”.

77. Xh.H deklaroi se incidenti ndodhi ndërmjet rrugës hyrëse për në spital dhe hyrjes për në rreth-rrotullim. Ai deklaroi se automjeti i tij ishte përparësisht 20 deri 30 metra larg kur filloi sulmi. Ai deklaroi se në atë moment, ai dhe kolegët e tij dolën nga automjeti i tyre dhe pastaj personat që po i sulmonin automjetet e delegacionit Serb filluan të largoheshin.

78. Xh.H. deklaroi se ai së pari e kuptoi se diçka nuk ishte në rregull, kur ai pa persona në të dyja anët e rrugës, në të majtë dhe në të djathtë, që po hidhnin gurë apo objekte të rënda. Ai deklaroi se me sa i kujtohet, ishin 2 persona në anën e majtë dhe 3 persona në anën e djathtë, por mund të kenë qenë 5 apo 6 ose më shumë. Ai deklaroi se ai nuk e ka ditur se çfarë po hidhnin këta njerëz pasi që ai nuk ishte i fokusuar në këtë. Ai deklaroi se ishin më shumë se një person që po

hidhnin objekte, por ai nuk mund të thoshte se sa. Ai deklaroi se ai pa objekte duke i goditur automjetet e delegacionit Serb.

79. Xh.H deklaroi se ai ishte 20 deri 30 metra larg kur filloi incidenti, por ai nuk ndaloi në atë distancë dhe në vend të kësaj ai u afrua me automjet deri mu në pikën e incidentit dhe pastaj doli jashtë, ku rezultoi se ai ishte më pak se pesë metra larg kur individët po i hidhnin objektet. Ai deklaroi se i tërë incidenti zgjati më pak se një minutë. Ai deklaroi se ai doli nga dera e prapme e djathtë e automjetit.

80. Xh.H deklaroi se kur ai dhe kolegët e tij dolën nga automjeti i tyre, nuk kishte ndarje formale të detyrave. Ai deklaroi se duke dalë nga automjeti, ata e vërejtën një mashkull që e kaloi rrugën “Fehmi Lladrovci” dhe shkoi drejt lagjes Ulpiana, përderisa dy të tjerët e kaluan rrugën dhe u shkuan përpjetë. Ai deklaroi se ai as nuk ishte i udhëzuar ta ndjekë ndonjërin dhe as ky nuk e udhëzoi asnjërin që ta bëjë këtë. Ai deklaroi se ishte ky dhe beson se ishte polici G.B. që filluan ti ndjekin dy meshkujt që vrapuan në drejtim të rr. “Agim Ramadani” dhe një zyrtar tjetër policor e ndoqi personin që vrapoi në drejtim të rr. “Fehmi Lladrovci”. Ai tha se ai personalisht i pa dy meshkujt që ai i ndoqi, duke hedhur objekte drejt konvojit të delegacionit. Ai deklaroi se ata ishin në veshje civile dhe pa ndonjë emblemë të caktuar.

81. Xh.H. deklaroi se këta dy meshkuj po vraponin tutje nga vendi i ngjarjes dhe ata u fshehën në një kafiteri. Ai deklaroi se ky beson se dy meshkujt nuk e kanë vërejtur këtë dhe kolegët e tij pasi që automjeti i tyre i policisë ka qenë i pa-markuar. Ai deklaroi se ai nuk i humbi nga shikimi ata që nga koha kur ata u larguan e deri në momentin kur ata u kapën dhe madje edhe i pa kur ata hynë në kafiteri dhe në cilën tavolinë u ulën ata. Ai deklaroi se ndjekja ishte shumë e

shkurtë. Ai deklaroi se kafiteria ishte njëra nga kafiteritë në rrugën “Agim Ramadani”, por nuk i kujtohej se cila.

82. Xh.H. deklaroi se kur ai hyri në kafiteri nuk kishte dyshime në mendjen e tij që dy personat e ulur aty dhe të cilëve ai iu afrua, kanë hedhur gurë te rreth-rrrotullimi. Ai deklaroi se ai ishte me një zyrtar tjetër policor dhe ata u përpoqën ti arrestonin të dy personat, por megjithatë, njëri iku. Ai deklaroi se ai dhe kolegu i tij e kapën personin tjetër dhe arritën edhe disa policë tjerë për të asistuar. Xh.H. deklaroi se personi që ai ia arriti ta kapte nuk kishte vështirësi në ecje apo në të vrapuar. Ai deklaroi se reagimi i tij pas arrestimit ishte normal, por jashtë kafiterisë të dy u përpoqën që të iknin, dhe personi tjetër ia arriti. Xh.H. deklaroi se i vetmi ndërveprim që ai kishte me personin që nuk iku ishte për ta pyetur atë për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe nëse ndoshta prangat kanë qenë shumë të ngushtuara apo shumë të zgjeruara. Ai deklaroi se i arrestuari nuk u ankua për ndonjë lëndim apo të kërkoi për ndonjë trajtim mjekësor.

83. Xh.H.. deklaroi se ai nuk ia ka ditur emrin këtij personi dhe as nuk ka mundur ta njoh më. Pastaj Prokurorja ia potencoi pretendimin e mbrojtjes se ai po e jep këtë dëshmi për ti rritur shanset e tija që të fitoj statusin e azilit në Francë, por Xh.H. e mohoi këtë dhe deklaroi se ai nuk ia ka përmendur këtë (apo ndonjë tjetër) rast, autoriteteve Franceze.

84. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga avokati mbrojtës i të pandehurit **K.D** avokat M.D., Xh.H.deklaroi se në atë ditë ai ishte me detyrë i caktuar për ta siguruar nga jashtë Zyrën Kadastrale të Kosovës, por ai ishte vendosur brenda kompleksit të objektit.

85. Xh.H.deklaroi se në momentin e sulmit, me aq sa ai ka mund të shoh, ishin dy persona në anën e majtë dhe tre persona në anën e djathtë të rrugës. Ai deklaroi se

ai doli nga automjeti nga ana e djathtë dhe i përcjelli personat që ishin në anën e djathtë. Ai e qartësoi se si automjeti i tij iu afrua delegacionit në rreth-rrotullim dhe si distanca ndërmjet tyre nuk ishte më e madhe se 10 metra, kur ndodhi sulmi. Ai deklaroi se kur ai dhe kolegët e tij dolën nga automjeti i tyre, sulmi kishte pushuar.

86. Avokati mbrojtës i të pandehurit **K.D** avokat M.D., pastaj ia potencoi dëshmitarit se distanca ndërmjet vendit të incidentit dhe vendit ku ndodhi arrestimi nuk ishte shumë e shkurtë dhe në fakt ishte distancë mjaft e gjatë, dhe madje edhe një vrapuesi atletik do ti duheshin dy apo tre minuta ta vraponte atë. Xh.H. u përgjigj se ai dhe kolegët e tij ecën në këmbë një pjesë të rrugëtimit dhe pastaj kolegët e tyre erdhën dhe i morën ata në automjete.

87. Xh.H. deklaroi se kishte edhe persona tjerë në kafiteri përveç dy meshkujve që ata i kishin përcjellë. Ai deklaroi se ai i pa këta dy persona kur ata e kaluan rrugën, hynë në kafiteri dhe u ulën në tavolinën e parë, duke ua kthyer shpinën dritareve dhe hyrjes, dhe duke qenë kështu të kthyer me fytyrë drejt pjesës së brendshme të kafiterisë. Ai deklaroi se ata nuk kishin pije në tavolinën e tyre. Ai deklaroi se të dy personave iu është kërkuar të dilnin jashtë dhe ti tregonin kartelat e tyre të identifikimit, dhe ata bënë ashtu pa kundërshtuar, por kur kolegu i tij iu tha se ata ishin personat që e sulmuan konvojin, atëherë ata filluan të iknin.

88. Xh.H. deklaroi se pas arrestit ai e thirri bazën e stacionit dhe kërkoi ndihmë për ta shoqëruar personin për në stacion, dhe njësia Alfa Sierra 101 erdhi rreth 10-15 minuta më vonë, e mori personin dhe e dërgoi atë në stacion. Ai deklaroi se pas kësaj ai nuk kishte të bënte asgjë me të. Ai nuk e dinte emrin e policit të cilit ai ia dorëzoi të pandehurin. Ai deklaroi se përpjekja e të arrestuarit për të ikur ishte i vetmi aspekt i rezistencës së tij ndaj arrestit. Ai nuk ishte në dijeni të jetë arrestuar ndonjë person tjetër.

89. Dëshmitari Xh.H.. deklaroi se ai është në Francë që prej nëntorit të vitit 2012.

90. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga i pandehuri **K.D.**, Xh.H. deklaroi se kur ai dhe kolegët e tij dolën nga automjeti i tyre, keqbërësit ishin 5 deri 10 metra larg tij, por gjatë ndjekjes keqbërësit fituan terren ndaj tyre dhe shumë shpejt i kaluan ata. Megjithatë, ai deklaroi se ai nuk e kishte humbur të pandehurin nga shikimi i tij për 70% të kohës. Ai deklaroi se ai u kthye në automjetin e tij dhe vazhdoi drejt rrugës “Agim Ramadani”, por ai i mbajti sytë tek keqbërësit dhe nuk i humbi ata nga shikimi i tij. Ai deklaroi se ai u kthye shpejt te një automjet tjetër pasi që ai e kuptoi se do të ishte më mirë ti ndjekë keqbërësit me automjet.

91. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga Gjyqtarja Witteman, Xh.H. nuk ishte në gjendje të thotë se sa ishte distanca nga semaforët e deri te kafiteria në rrugën “Agim Ramadani”. Ai deklaroi se të dyshuarit ishin të skuqur në fytyrë dhe po gulçonin kur ai hasi në ta në kafiteri.

92. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga kryetarja e trupit gjykues, Xh.H.. e konfirmoi se ai ishte në gjendje ti mbaj në shikim keqbërësit të shumtën e kohës që ai ishte vozitur në veturën e pa-markuar. Ai u pajtua se ai nuk i pa ata 100 % të kohës pasi që iu nevojiti të shikoj se ku po shkonte. Ai nuk ishte duke vozitur. Ai ishte i sigurt se ata nuk u fshehën apo hynë në ndonjë objekt.

93. Xh.H. deklaroi se personi që vrapoi në drejtim të Ulpianës ishte me fizik mesatar dhe jo i dobët sa ata dy që ikën. Ai nuk mund të deklaronte sesa këmbësorë ishin në afërsi, kur filloi sulmi, por aludoi se ishin ndërmjet 10 dhe 50. Ai deklaroi se edhe pse ishte një lloj bllokimi i trafikut kur ndodhi sulmi, ai prapëseprapë mund ta shihte sulmin dhe keqbërësit shumë qartazi. Ai tha se këmbësorët tjerë nuk e penguan pamjen e tij drejt dy keqbërësve që ai ishte duke i ndjekur.

94. Xh.H.. deklaroi se ai ishte 100% i sigurt që njëri nga dy personat që ai i hasi në kafiteri dhe të cilin ai e udhëzoi të dilte jashtë për ta identifikuar veten, ishte njëri nga personat që e kreu sulmin në rreth-rrotullim. Megjithatë, ai gjithashtu deklaroi që në ditën që ndodhi incidenti, ai do të ishte në gjendje ti identifikoj të tre keqbërësit, por tani, tri vite e gjysmë më vonë, ai mund të mos jetë në gjendje ta identifikoj as personin që ishte në kafiteri dhe i cili është prangosur.

95. Kryetarja e trupit gjykues pastaj ia potencoi Xh.H.t që në deklaratën e tij në shtator të vitit 2013, ai deklaroi, *“Unë isha prapa konvojit kur ndodhi. Unë pashë persona tjerë duke hedhur gurë dhe unë vrapova vetëm pas një individi dhe unë nuk pashë shumë persona tjerë. Tani unë nuk mund ta identifikoj personin e dytë, i cili iku”*, por tani ai po thoshte se ai i pa fytyrat e të gjithë sulmuesve dhe ishte në gjendje ti identifikoj ata. Ajo i kërkoi atij që ta shpjegoj këtë kontradiktë.

96. Si përgjigje Xh.H. thjesht deklaroi se ai qëndroi prapa raportit të tij të përpiluar në prill të vitit 2012. Megjithatë, kryetarja e trupit gjykues ia potencoi atij se në atë raport ai deklaroi se ai i pa tre persona duke hedhur gurë, përderisa tani ai po thoshte se ishin pesë. Si përgjigje ai deklaroi se ai i pa 5 persona, por pasi që ata e arrestuan vetëm një person, kur ata u kthyen në stacion policor “ata” u thanë atyre ta shkruajnë tre persona. Ai deklaroi se me sa i kujtohet atij njerëzit po hidhnin gurë nga të dyja anët e rrugës dhe sulmi ndodhi shumë shpejt.

97. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga avokati mbrojtës M.D., Xh.H. deklaroi se që të dy, automjeti i tij dhe delegacioni po lëviznin, dhe kur ndodhi sulmi, ata e kishin ngushtuar distancën ndërmjet automjetit të tyre dhe delegacionit. Ata arritën në vend të ngjarjes dhe zbritën nga automjeti i tyre. Ai deklaroi se në momentin e sulmit, automjetet Serbe ishin ndalur dhe ato po prisnin, kështu që të dyshuarit u afruan drejt konvojit.

98. Më 1 shtator 2015, trupi gjykues e mori dëshminë nga dëshmitari H.B.. Ai e konfirmoi se ishte intervistuar mbi ngjarjes në fjalë më 12 dhjetor 2012. Ai deklaroi se në prill të vitit 2012 ai ishte këshilltar për Bankën Qendrore të Kosovës. Megjithatë, ai ka punuar për Agjencinë Kadastrale të Kosovës për dhjetë vite para kësaj, dhe ai ishte ftuar të marr pjesë në takim me delegacionin Serb, më datën 4 prill 2012. Ai deklaroi se qëllimi i takimit ishte implementimi i marrëveshjes që ishte arritur në Bruksel, sa i përket kadastrit. Ai deklaroi se ishte një takim zyrtar e jo një takim mirësjellje. Ai deklaroi se derisa kishte shkuar në shtëpi dhe shikuar në TV ai nuk e kishte kuptuar se ishte sulmuar delegacioni. Ai nuk ishte në gjendje të jap dëshmi mbi atë sesi kishte ndodhur sulmi, e aq më pak se kush mund të ketë qenë përgjegjës për sulmin.

99. Dëshmitari i radhës ishte B.B... Ai dha dëshmi përpara trupit gjykues më datën 2 shtator 2015. Ai ishte një zyrtar policor dhe hetues i forensikës, i cili, më 4 prill 2012, ishte praktikant nën mbikëqyrjen e policit E.D... Atij iu kujtua ti ketë parë dy veturat, por ai nuk ishte i autorizuar të merrej me rastin, por vetëm të shikoj sesi zhvillohej procedura. Ai deklaroi se i kujtohej se njëri automjet ishte Audi dhe tjetri Shkoda.

100. B.B deklaroi se mendimi i tij ishte se dëmet në të dyja automjetet ishin të vogla, domethënë xhama të thyer dhe ndrydhje në karroceri. Ai pa gurë brenda njërit automjet dhe ai presupozoj se ata gurë e kishin thyer xhamin. Ai deklaroi se gurët ishin të madhësisë që mund të mbaheshin në dorë. Ai deklaroi se me sa i kujtohej njëri automjet i kishte të dyja dritaret e përparme të thyera, përderisa tjetri e kishte të thyer vetëm në anën e shoferit. Kur i janë treguar fotografi nga prokurorja, ai i njohu veturat e dëmtuara.

101. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 14 shtator 2015, Prokurorja zyrtarisht u tërhoq nga dëshmitarët që ishin pjesë e delegacionit zyrtar dhe në konvoj⁸. Ajo deklaroi se ata do të ishin në gjendje të dëshmonin vetëm për faktin e vet sulmit, përderisa çështja aktuale në rast është ajo e identifikimit.

102. I pandehuri **K.D.** edhe vet dha dëshmi në seancën e shqyrtimit gjyqësor, më datën 9 nëntor 2015. Në këtë seancë, ai është përfaqësuar nga një avokat tjetër mbrojtës, domethënë A.S., të cilin trupi gjykues e caktoi *ex officio* për ta zëvendësuar avokatin e mëparshëm mbrojtës, pasi që i pandehuri kishte pohuar në seancë të datës 7 tetor 2015, se ai nuk po e përfaqësonte atë në mënyrën sesi ky dëshironte. Trupi gjykues e caktoi avokatin mbrojtës A.S., për ta përfaqësuar të pandehurin. Trupi gjykues dëshiron ta përgëzoj z. . S. për profesionalizmin me të cilin ai e trajtoi rastin, përkundër asaj që është kyçur në të, në një moment relativisht të vonshëm.

103. **K.D.** deklaroi se në atë ditë ai po pinte kafe në një kafiteri jo të kushtueshme, që ishte e popullarizuar tek studentët. Ai ishte vetëm, por kishte njerëz tjerë në kafiteri. Ai deklaroi se ai arriti në kafiteri për afërsisht në ora 15:00, dhe policia erdhi për afërsisht në ora 16:00, por ai nuk mund të ishte i sigurt për këto kohë, pasi që ai nuk e ka shikuar orën e tij. Ai deklaroi se ai ishte ulur dhe po e pinte kafën e tij kur ata hynë brenda. Atij nuk i kujtohet saktësisht sesa policë ishin. Ata iu afruan atij dhe i thanë të ngrihet në këmbë dhe thanë “*Ne duhet t’iu arrestojmë juve*”. Ai deklaroi se ai i pyeti “*Përse?*”, por ata nuk u përgjigjën, por në vend të kësaj u bënë agresiv. Ai deklaroi se ai u tha atyre ta marrin shtruar dhe u tha “*Unë*

⁸ Kryetarja e trupit gjykues bëri përpjekje t’ua dorëzoj thirrjet dëshmitarëve në Serbi, përmes Zyrës Ndërlidhëse të UE-së në Beograd. Megjithatë, për shkak të vështirësive të vazhdueshme ndërmjet Ministrive të Drejtësisë në Kosovë dhe Serbi përkatësisht, kjo doli të jetë e pamundshme. Rrjedhimisht, dëshmitari **D.P.** e mori përsipër ti dorëzoj këto thirrje, por ai nuk ktheu asnjë dëftesë për dorëzimin. Ai e konfirmoi përmes telefonit se dëshmitarët i kanë pranuar ato, por ata nuk u paraqitën në asnjërën nga seancat e shqyrtimit gjyqësor.

jam i lënduar dhe çdo gjë do të bëhet mirë” dhe ai u përpoq ta mbronte këmbën dhe ata ia vendosën prangat në duar të tija.

104. **K.D.** deklaroi se atij i duhej ta mbronte këmbën e tij pasi që ai e kishte të shqyer ligamentin dhe meniskun. Ai deklaroi se ai nuk e dinte nëse këto lëndime ai i kishte pësuar dy apo tri vite më parë, por ai ishte nën trajtim të vazhdueshëm mjekësor. Ai deklaroi se ai ia dorëzoi prokurorisë dokumentacionin dëshmues për këtë. Ai deklaroi se në terme praktike, lëndimi i tij domethënë se ai nuk mund të vraponte dhe mund të ecte vetëm në distanca të shkurta dhe atë në mënyrë të kujdesshme. Ai nuk mund të angazhohej në aktivitete sportive. Aktualisht ai nuk ishte nën ndonjë trajtim mjekësor.

105. **K.D.** deklaroi se ai nuk e njihte zyrtarin policor Xh.H.... Avokati i tij mbrojtës ia potencoi atij se Xh.H.. e identifikoi atë dhe ai personalisht e arrestoi atë në kafiteri në ditën e incidentit të pohuar, por **K.D.** deklaroi se e kishte parë atë për herë të parë vetëm kur ai e dha dëshminë e tij përmes video-lidhjes, më 1 shtator 2015. Ai ishte i qartë që ai, Xh.H..., nuk ishte i pranishëm në kafiteri gjatë arrestimit të tij më 4 prill 2012.

106. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga prokurorja, **K.D.** deklaroi se policët që e arrestuan ishin agresiv dhe nuk i dhanë atij mundësinë për të folur me ta. Ai deklaroi se ai gjithashtu as nuk dha deklaratë zyrtare në stacion policor në atë ditë. Atij nuk i kujtohet se a i ka dhënë deklaratë prokurorit të EULEX-it më datën 7 dhjetor 2012. Ai e pranoi që dokumenti që ai dorëzoi më 20 tetor 2014, ku kërkonte hedhjen poshtë të aktakuzës ishte hera e parë që ai e ofroi dëshminë e tij lidhur me atë çfarë kishte ndodhur më 4 prill 2012, dhe kjo ishte dy vite, gjashtë muaj dhe gjashtëmbëdhjetë ditë pas incidentit që pretendohet të ketë ndodhur.

107. **K.D.** e pranoi se në këtë dokument ai kishte deklaruar *“Unë u luta atyre, domethënë zyrtarëve policorë, të më arrestojnë qetazi për shkak se unë nuk mund ta lëvizja këmbën time të djathtë, e cila ishte 90 përqind e paaftë. Unë e kisha shqyer ligamentin dhe meniskun e gjurit për disa muaj tashmë”*. Prokurorja ia potencoi atij fletë-lëshimin e spitalit rajonal të Prizrenit ku ai ishte pranuar më 8 maj 2012 dhe lëshuar më 14 maj 2012, i cili thotë: *“pacienti erdhi në spital për një lëndim në gjurin e majtë. Lëndimi ka ndodhur si rezultat i një rrëzimi që kishte ndodhur para tri viteve”*, dhe e pyeti përse ai tani po thotë që lëndimi ishte në gjurin e tij të djathtë. **K.D.** u përgjigj se lëndimi ishte në *“anën e majtë të këmbës së djathtë”*. Ai e pranoi se ai e pësoi lëndimin në vitin 2009 ose 2010. Ai deklaroi se ai ishte në listë të pritjes për operim tashmë një kohë të gjatë. Ai deklaroi se ai ishte trajtuar dhe operuar në Prizren.

108. Prokurorja ia potencoi **K.D.**...t që parashtresa e tij të tetorit të vitit 2014, thoshte se ai e kishte shqyer ligamentin dhe meniskun e tij *“që prej disa muajve” (disa muaj)*. **K.D.** deklaroi se kur fillimisht ndodhi lëndimi, diku deri për një vit ai eci me paterica, dhe pas asaj periudhe ai ishte në listë të pritjes për operim dhe gjatë tërë kohës ishte duke marrë terapi. Ai deklaroi se ai shkonte rregullisht në spital për trajtim me akull dhe i ishte thënë se ende nuk kishte ardhur radha e tij.

109. Prokurorja ia potencoi **K.D.**...t se ai po pohonte se ai ishte duke marrë trajtim mjekësor së paku që prej vitit 2009, por nuk kishte prova mjekësore për ta vërtetuar këtë deklaram të tij që ai ishte i lënduar më 4 prill 2012. Ai u përgjigj se ai nuk mund të përgjigjet me *“po ose jo”*, por ai e kishte dorëzuar të gjithë dokumentacionin mjekësor që ai e posedonte. Ai deklaroi se ai nuk ishte duke përdorur mjete ndihmëse për të ecur në ditën e arrestimit të tij. Ai deklaroi se në atë kohë ai ishte duke banuar në Prishtinë.

110. **K.D...** insistoi se ai nuk u mundua të ikte nga zyrtarët policorë as përpara e as pas arrestimit të tij. Kur prokurorja e pyeti nëse ai u përpoq t'ua shpjegonte policëve që e arrestuan se ky ishte një rast i identifikimit të gabuar, ai tha se ata u përgjigjën: *“ne e dimë këtë”* dhe ata nuk thanë asgjë tjetër dhe ata ishin shumë agresiv, posaçërisht kur arriti zonja rreshtere.

111. Në përgjigjen ndaj pyetjes nga avokati i tij mbrojtës, **K.D...** deklaroi se ai e pësoi lëndimin në gju duke lozur futboll dhe kishte dëshmitarë. Ai deklaroi se ai nuk kishte dënime të mëparshme penale dhe kjo ishte hera e parë që ai është hetuar për një vepër penale.

112. Në përgjigje ndaj pyetjes nga Gjyqtarja Witteman, **K.D..** e tregoi në hartë lokacionin e kafiterisë në të cilën ai është arrestuar. Ai deklaroi se ishte i ulur në anën e majtë të hyrjes së kafiterisë. Ai deklaroi se ai nuk e ka pa askënd jashtë.

113. **K.D...** më tutje deklaroi se ai ishte aktivist në lëvizjen politike *“Vetëvendosje”*. Ai deklaroi së me rastin e arrestimit të tij, policia i tha atij se është kapur edhe një aktivist tjetër dhe ai po e priste këtë në stacion policor. Ai pohoi se ata i thanë atij se ata e kishin arrestuar atë në vend të ngjarjes dhe emri i tij ishte Xh.. Megjithatë, **K.D...** deklaroi se kur ata arritën në stacion, ai ishte vendosur në një dhomë, dhe pastaj është dërguar (i prangosur) te Xh.. Ai deklaroi se ai ishte dërguar në paraburgim për një periudhë prej 72 orësh dhe atij i ishte treguar një person të cilin ai nuk e kishte njohur, dhe ata e pyetën atë: *“a e ke parë këtë sot në vend të ngjarjes”?* dhe ky iu tha: *“Unë kurrë nuk e kam parë atë”*. Ai deklaroi se ky person ishte anëtar i parlamentit, z. Xh.C., nga komuna e Rahovecit. **K.D** deklaroi se ky njëri është liruar dhe policia tha: *“nëse ai është liruar, përse ne duhet ta mbajmë tjetrin”* dhe një epror i policisë tha: *“ky nuk është vendim i juaj dhe është një çështje që ne po presim të na arrijë një urdhër”*. Ai deklaroi se ky

epror i policisë ishte femra rreshtere. Ai deklaroi se një zyrtar policor tha: *“dikush duhet ta marrë këtë përsipër dhe ne duhet ta dëshmojmë disi se ne e kemi arrestuar një person dhe dërgojeni këtë person në mbajtje duke marrë parasysh se ora 24:00 e mbrëmjes tashmë ka kaluar. Ata nuk do të flasin apo të thonë ndonjë gjë. Dërgojeni vetëm në mbajtje”*.

C. DOCUMENTARY EVIDENCE

114. Trupi gjykues mori dhe shqyrtoi gjësendet vijuese nga provat e dokumentuara:

- (a) Tërë përmbajtjen e dosjes së rastit nga prokuroria PP. 776-3/2012;
- (b) Letrën nga Zyrtari i Përbashkët për Shërbime të Organeve Republikane të Serbisë⁹;
- (c) CD që përmban fotografi të incidentit të pohuar, të vendosura në YouTube, të dorëzuara nga prokuroria¹⁰;
- (d) Përgjigjen e Komunës së Prishtinës në pyetjen e trupit gjykues për hartat dhe fotografitë¹¹;
- (e) Përgjigjen e Spitalit Rajonal të Prizrenit në pyetjen e trupit gjykues rreth trajtimit të të pandehurit¹²;
- (f) Raportin e trajtimit dhe fletë-lëshimin nga Spitali Rajonal i Prizrenit¹³;
- (g) Fotografitë e lokacionit gjeometrik, të dorëzuara nga Mbrojtja¹⁴;
- (h) Parashtrësën e të pandehurit **K.D.**¹⁵;
- (i) Fotografitë e lokacionit gjeometrik¹⁶;

⁹ Dosja e shqyrtimit gjyqësor Volumi I në tab B

¹⁰ Dosja e shqyrtimit gjyqësor Volumi III në cover index

¹¹ Dosja e shqyrtimit gjyqësor Volumi III në Tab 10

¹² Do. në Tab 11

¹³ Do. Volumi III në Tab 15

¹⁴ Do. Volumi III në Tab 16

¹⁵ Do. Volumi III në Tab 17

- (j) Përgjigjen e Agjencisë Kadastrale të Kosovës¹⁷;
- (k) Përgjigjen e Drejtorit të Inspektoratit¹⁸;
- (l) Përgjigjen e Shërbimeve Klinike Universitare¹⁹

D. ANALIZA TË PROVAVE dhe TË GJETURAT FAKTIKE

115. Nuk kishte kontestime se më 4 prill 2012, përafërsisht në ora 16:15, një konvoj zyrtar prej dy automjeteve që ishte pjesë e një delegacioni Serb se sapo e kishte përfunduar një takim me autoritetet Kosovare, në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ishte sulmuar nga persona duke hedhur gurë, derisa po kalonte përgjatë rr. “Muharrem Fejza” në drejtim të rreth-rrotullimit në udhëkryqin e asaj rruge dhe rrugës “Fehmi Lladrovci”. Të dyja automjetet janë dëmtuar në sulm dhe një pasagjer pësoi lëndime të lehta në kokë. I pandehuri **K.D** është ndjekur penalisht me veprat penale të pretenduara në lidhje me këtë incident.

116. Prokurorja, i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës ia paraqitën trupit gjykues fjalimet e tyre përmbyllëse në formë të shkruar, dhe këto kanë ndihmuar shumë në identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve kyçe në këtë rast. trupi gjykues i falënderon palët për këtë.

117. Incidenti është filmuar (me gjasë me anë të telefonit celular) dhe filmimi më vonë është vendosur në YouTube. Filmimi zgjat 44 sekonda dhe përderisa kualiteti është pak i vrazhdë dhe me dridhje, megjithatë është i deshifrueshëm. Filmimi fillon pasi që sulmi tashmë kishte ndodhur. I paraqet tre policë të uniformuar të Policisë së Kosovës, dy nga të cilët²⁰ duket të kenë dalë nga një automjet Golf V i

¹⁶ Do. Volumi III në Tab 19

¹⁷ Do. Volumi III në Tab 30

¹⁸ Do. Volumi III në Tab 29

¹⁹ Do. Volumi III në Tab 28

²⁰ Policët **Xh.H.** dhe **G.B.**

markuar i Policisë së Kosovës, në vendkalimin e këmbësorëve në rr. “Muharrem Fejza” në Prishtinë. Filmimi i paraqet dy persona duke ikur me vrap nga ata, në një distancë prej fillimisht 5 deri 10 metrash. Së pari, policët fillojnë ti ndjekin në këmbë, por e lënë këtë pas vetëm disa metrash pasi që dy personat fitojnë terren ndaj tyre dhe ata presupozohet se e kuptojnë se nuk mund ti kapin ata në këmbë. Është e pamundshme ti përshkruash këta persona përtej të vërejturit se ai më përpara duket të jetë më i vogël sesa ai më prapa.

118. Filmimi pastaj kalon tek vet delegacioni Serb për përfaqësim të tridhjetë sekonda. Dritaret e anës së shoferit të automjeteve Shkoda Octavia dhe Audi A8 të dyja kanë pësuar dëme të qarta të një lloji që konsiston me atë të qënurit të goditura nga një guri apo ndonjë objekti të ngjashëm. Automjetet paraqiten duke vazhduar poshtë rr. “Fehmi Lladrovci” në drejtim të rreth-rrrotullimit në udhëkryqin me Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”. Ata përcillen nga një SUV i markuar, i bardhë, i Policisë së Kosovës. Trupi gjykues konkludoi se përderisa filmimi ishte i dobishëm deri diku për atë se e ka bërë të mundshme “ta përfytyrojmë vendngjarjen”, kishte pak vlerë dëshmuese në përcaktimin e çështjes së fajësisë apo pafajësisë së të pandehurit.

119. Siç u deklarua nga prokurorja, në të dyja rastet, gjatë gjykimit dhe në fjalën e saj përfundimtare, çështja kyçe në këtë rast ishte identifikimi i të pandehurit **K.D.** si person që ka hedhur gurë në konvojin zyrtar të automjeteve Serbe në Prishtinë, më 4 prill 2012, dhe dëshmitari kyç në lidhje me këtë ishte ish zyrtari policor i atëhershëm, Xh.H.. Xh.H. u largua nga Kosova në nëntor të vitit 2012 dhe ai tani është duke kërkuar azil në xxx.

120. Deklarata e parë e policit H. në lidhje me ngjarjet e 4 prillit 2012, është bërë në atë datë. kjo deklaratë në fakt ka qenë raporti i tij zyrtar mbi incidentin. Si e tillë

është jashtëzakonisht e shkurtë. Në thelb, ajo mund të përmblihet në një deklaratë që përderisa konvoji iu afrua rreth-rrotullimit në udhëkryqin e rr. “Muharrem Fejza” dhe rr. “Fehmi Lladrovci”, tre persona filluan të hidhnin gurë në drejtim të automjeteve. Menjëherë njësia e tij filloi ti ndjekë të dyshuarit dhe së bashku me një njësi tjetër ata ia arritën ta ndalojnë njërin nga ata në rr. “Agim Ramadani” pranë fakultetit teknik. Ai deklaroi se Njësia AS-101 erdhi dhe e transportoi këtë person për në stacion, dhe njësia e tij patrolloi për ca kohë duke i kërkuar të dyshuarit e tjerë, por nuk i pa ata.

121. Xh.H. ia dha një deklaratë më të detajuar Policisë Franceze në shtator të vitit 2013. Trupi gjykues është i kënaqur që kjo deklaratë është dhënë në mënyrë vullnetare dhe nuk ka dëshmi për të sugjeruar se ka qenë e ndikuar në ndonjë mënyrë nga aplikimi i Xh.H.’s.t për azil në xxx. Përkundrazi, trupi gjykues e vlerësoi Xh.H.n, si dëshmitar të besueshëm i cili nuk kishte asnjë arsye për të gënjyer, dhe ç’ është në fakt, kur ai nuk e dinte apo nuk i kujtohej diçka apo kur ka bërë diçka që nuk është duhur ta bënte, ai thjesht e tha këtë.

122. Në këtë deklaratë Xh.H. deklaroi se ai pa “njerëz” duke hedhur gurë në konvoj. Ai deklaroi se ishin pesë zyrtarë policorë në automjetin e tij. Ata e ndaluan automjetin e tyre dhe secili polic vrapoi në drejtim të një individi. Ai, i shoqëruar nga polici G.B. me numër 5451, vrapoi në drejtim të një individi. Ai deklaroi se ata e arrestuan një individ dhe e prangosën atë. Ai deklaroi që një individ tjetër iku dhe personi i arrestuar ishte i vetmi person të jetë arrestuar në lidhje me incidentin. Ai deklaroi se ai ishte i sigurt se ai e pa personin e arrestuar duke hedhur gurë në drejtim të konvojit dhe ai nuk e humbi nga shikimi përderisa po vraponte. Ai deklaroi që “ne” ia dorëzuan këtë individ zyrtarëve tjerë policorë, të cilët e dërguan atë në stacion policor. Ai deklaroi se ai nuk mundi ta njeh personin e dytë i cili iku. Ai deklaroi se arrestimi ndodhi afër 150 metra larg nga konvoji, në

rrugën “Agim Ramadani”. Ai deklaroi se personi që ai e arrestoi nuk bëri rezistencë, por kishte mbetur pa frymë. Ai deklaroi se ai kurrë nuk e humbi nga shikimi atë. Ai deklaroi se ai e pa qartazi individin që ai e arrestoi, duke hedhur gurë drejt dritareve të automjeteve dhe ishte e qartë se ai po qëllonte në drejtim të dritareve.

123. Kur Xh.H. u dëgjua përmes video-lidhjes nga trupi gjykues në shqyrtim gjyqësor, kujtesa e tij mbi incidentin ishte ndryshe. Ai deklaroi se pesë njerëz e sulmuan konvojin, dy në anën e majtë të rrugës dhe tre në anën e djathtë. Kujtimet e tija se ai ishte 20 deri 30 metra larg kur filloi incidenti dhe më pak se pesë metra kur ai doli nga automjeti i tij, janë në përputhje me filmimin në YouTube. Trupi gjykues e pranon dëshminë e tij se ai vet dhe polici G.B. filluan ti ndjekin dy meshkujt që vrapuan në drejtim të rr. “Agim Ramadani” dhe një zyrtar tjetër policor e ndoqi personin që vrapoi në drejtim të rr. “Fehmi Lladrovci”. Ajo gjithashtu e pranon dëshminë e tij se ai personalisht i pa dy meshkujt që ai i ndoqi, duke hedhur objekte drejt konvojit të delegacionit edhe pse ai e pranoi se ata ishin në veshje civile dhe pa ndonjë emblemë të dalluar.

124. Megjithatë, nga ky moment e tutje, dëshmia e Xh.H.’t bëhet më pak e besueshme. Deklarata e tij se ai i mbajti në pamje të tij dy meshkujt që nga momenti që ata u larguan e deri te momenti kur ata u kapën, se ai i pa kur ata hynë në kafiteri dhe madje edhe në cilën tavolinë u ulën ata, dhe nuk kishte dyshime në mendjen e tij se ata kishin hedhur gurë në automjete, është minuar në marrjen në pyetje tërthorazi, kur ai e pranoi se ata ishin në pamje të tij “*shtatëdhjetë përqind të kohës*”. Trupi gjykues pajtohet me këtë. Xh.H duhej ti humbte nga pamja ata derisa ai u kthye tek një automjet tjetër që e mori atë, hyri brenda në automjet, dhe vozitën poshtë rrugës “Muharrem Fejza”, u kthyen djathtas në rreth-rrotullim, vozitën lartë rrugës “Fehmi Lladrovci”, u kthyen djathtas në rrugën “Agim

Ramadani”, dolën nga automjeti dhe hynë në kafiteri. Trupi gjykues gjen se në këto rrethana, Xh.H nuk ka mundur ti ketë këta dy meshkuj në pamjen e tij për më shumë se shtatëdhjetë përqind të kohës që ai i ka përcjellë ata.

125. Sidoqoftë, ky boshllëk në rastin e prokurorisë nuk ishte patjetër fatal sikur të mos ekzistonin disa probleme tjera. Në dëshminë e tij për trupin gjykues, Xh.H. deklaroi se ai nuk e diti emrin e personit që ai e ka arrestuar dhe as nuk ka mundur ta njohë atë më. Ky pranim, kur merret parasysh së bashku me atë që ai e pranoi se ai nuk i humbi nga sytë e tij keqbërësit për vetëm shtatëdhjetë përqind të kohës pas sulmit, e krijoi një dyshim të arsyeshëm në mendjet e trupit gjykues për besueshmërinë e identifikimit të tij.

126. Një dyshim i mëtejshëm dhe më serioz ishte krijuar nga dëshmia e Xh.H.t për trupin gjykues, më 1 shtator 2015, kur u pyet nga kryetarja e trupit gjykues të jap llogari për mospërputhjet në dëshminë e tij mbi çështjen se sa njerëz e kanë sulmuar konvojin. Ai deklaroi²¹

Xh.H.: E vërteta është se aty kishte njerëz në të dyja anën e rrugës që po hidhnin gurë. Pasi që ne e arrestuam një person, është e vërtetë se unë i pashë 5 persona, por kur ne shkuam në stacion policor ata na thanë neve ta shkruajmë 3 persona.

127. Nga kjo dëshmi duket se Xh.H. është udhëzuar nga (një) tjetër polic(ë) që të deklaroi në raportin e tij të datës 4 prill 2012, se ishin vetëm tre keqbërës, për shkak se policia ia kishte arritur ta kapte vetëm një të dyshuar dhe kjo do të dukej më pak paaftësi sesa sikur të ishin pesë sulmues. Trupi gjykues e konsideron këtë zhgënjyese dhe shumë për të ardhur keq që ndonjë zyrtar(ë) policor(ë) do të brengosej me këtë dhe për më shumë që një raport do të falsifikohet për ta mbështetur një përshtypje të tillë të devijuar.

²¹ At page 28 of the English version

128. Është plotësisht e papranueshme që një polic duhet të deklaroj në ndonjë raport diçka që ai/ajo e din të jetë e pavërtetë, dhe për më shumë nëse kjo është bërë me urdhër të (një) polici tjetër. Kur përballemi me prova të ndërhyra në këtë mënyrë, trupi gjykues është i detyruar ta pyes veten se çfarë tjetër në këtë rast ka deklaruar polici, ose në bazë të iniciativës së tij ose sipas udhëzimeve të tjerëve, të cilat ai e ka ditur të jenë të pavërteta?

129. Trupit gjykues i erdhi ndërmend se prokurorja është dashur të tërheq aktakuzën kundër të pandehurit **K.D** kur Xh.H. e dha këtë dëshmi. Me këtë rast, trupi gjykues erdhi në përfundim se do të ishte tërësisht e pasigurt që të mbështetemi në dëshminë e Xh.H.t, pasi që besueshmëria e tij është humbur në paktim me pranimin e tij se ai me vetëdije ka vendosur informata të rrejshme në raportin e tij fillestar. Kur trupi gjykues e arriti këtë konkluzion, nuk kishte alternativë tjetër përveç ta shpallte të pandehurin **K.D.** të pafajshëm për të dyja veprat penale, përpara gjykatës.

130. I pandehuri **K.D.** dha dëshmi se ai e pësoi një lëndim në gju në vitin 2009 apo 2010, i cili kërkonte trajtim dhe operim të mundshëm në Maj të vitit 2012. Rasti i tij ishte se ky lëndim e parandaloi atë nga ikja me vrap nga vendi i sulmit në mënyrën e përshkruar, dhe për këtë, ai nuk ishte personi që Xh.H.. pohoi ta ketë vëzhguar dhe ndjekur. I pandehuri **K.D.** prezantoi prova në formë të dokumenteve për ta mbështetur pohimin e tij.

131. Trupi gjykues konkludoi se, përderisa i kishte disa dyshime lidhur me autenticitetin e dokumenteve të paraqitura nga i pandehuri, ai me gjasë e ka pësuar lëndimin për të cilin është ankuar në kohën që ai e pohoi. Përveç kësaj, ai me gjasë i është nënshtruar trajtimit për të cilin pohon ti jetë nënshtruar. Megjithatë, trupi gjykues gjithashtu erdhi në përfundim se ky lëndim sipas të gjitha gjasave nuk do

ta parandalonte të pandehurin **K.D.** nga kryerja e sulmit dhe ikja në këmbë më pastaj.

132. Duhet që gjithashtu të thuhet se edhe nëse trupi gjykues ka ardhur në përfundim se i pandehuri tërësisht i ka fabrikuar të dyja, faktin dhe efektin e lëndimit të tij, kjo nuk do ta zvogëlonte peshën mbi prokurorinë për ta dëshmuar fajësinë e tij përtej dyshimit të arsyeshëm, gjë që në fund ata dështuan ta bëjnë.

133. Në një mënyrë të ngjashme, provat tjera që i pandehuri **K.D.** i paraqiti apo u përpoq ti paraqiste, në lidhje me ndryshimet në topografinë e zonës nga rruga “Muharrem Fejza” deri te rreth-rrotullimi, dhe prej aty e lart deri në rrugën “Fehmi Lladrovci” e rrugën “Agim Ramadani”, në fund të fundit ishin me pak rëndësi apo pa rëndësi fare për çështjen e fajësisë apo pafajësisë së tij, dhe në përputhje me këtë trupi gjykues nuk bënë gjetje faktike duke u bazuar në këto parashtresa.

E. KONKLUDIMET

134. Neni 3 i KPP-së parashikon siç vijon:

Prezumimi i Pafajësisë së të Pandehurit dhe In Dubio Pro Reo

1. Çdo person i dyshuar apo akuzuar me një vepër penale, do të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij apo saj të përcaktohet me një aktgjykim final të gjykatës.

2. Dyshimet në lidhje me ekzistencën e fakteve të rëndësishme për rastin apo dyshimet në lidhje me implementimin e ndonjë dispozite të caktuar ligjore, do të interpretohet në favor të të pandehurit, dhe të drejtave të tij apo saj sipas Kodit aktual dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

135. Në këtë rast gjykata kishte dyshimet fillestare mbi dëshminë e Xh.H..t, kur ai deklaroi se personat që ai i ndoqi nga vendi gjeometrik (*locus*) nuk i kishte humbur nga shikimi vetëm 70% të kohës. Këto dyshime janë mbledhur me pamundësinë e tij për ta kujtuar emrin e personit që ai e ka arrestuar apo për ta njohur atë në sallë të gjyqimit. Si diçka e mënjanë dhe e dobishme për retrospektivë, do të kishte qenë një ushtrim i dobishëm për Xh.H. sikur ta kishte identifikuar zyrtarisht personin që ai e arrestoi në një rreshtim të mëvonshëm të identifikimit, posaçërisht pasi që ai nuk e dërgoi atë në stacion policor dhe as nuk e procedoi atë atje.

136. Megjithatë, edhe nëse Xh.H.. do të dëshmonte se ai kurrë nuk e ka humbur nga pamja personin që ai e ndoqi dhe ai të ishte në gjendje që ta mbante mend emrin dhe pastaj edhe ta njohte atë, trupi gjykues prapëseprapë do të shpallte të pandehurin **K.D.** të pafajshëm, mbi bazat që raporti i Xh.H..t i datës 4 prill 2012 përmbante informata që ai i dinte dhe e pranoi se ishin të rrejshme, dhe kështu e humbi në pa-kthim besueshmërinë e tij në sytë e gjykatës.

F. SHPENZIMET E PROCEDURËS

137. Pasi që i pandehuri **K.D.** është shpallur i pafajshëm, shpenzimet e procedurës duhet të mbarten nga buxheti i Republikës së Kosovës.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

P. nr. 357/14

E datuar më 18 Shkurt 2016

Mariola Pasnik

Kryetare e trupit gjykues

Katrien Gabriël Witteman

Anëtare e trupit gjykues

Naime Jashanica

Anëtar i trupit gjykues

Dea Dedi

Procesmbajtës